

Biznesi, të drejtat e njeriut dhe mjedisi

E ardhmja e biznesit
të qëndrueshëm në
Ballkanin Perëndimor







SUSTINERI
PARTNERS



THE AIRE CENTRE
Advice on Individual Rights in Europe

Biznesi, të drejtat e njeriut dhe mjedisi

E ardhmja e biznesit të qëndrueshëm
në Ballkanin Perëndimor

Redaktorë:

Biljana Braithwaite, Drejtoreshë e Programit
për Ballkanin Perëndimor (Qendra AIRE),
Partnere Themeluese & Kryeshefe Ekzekutive (Sustineri Partners)

Dr Marija Jovanovic, Ligjëruese e të Drejtës (Universiteti Essex),
Partnere Themeluese (Sustineri Partners)

Kontribuesit kryesorë:

Dr Marija Jovanovic, Ligjëruese e Të Drejtës (Universiteti Essex),
Partnere Themeluese (Sustineri Partners)

Aleksandra Njagulj, Eksperte për menaxhimin e investimeve ESG,
Partnere Themeluese (Sustineri Partners)

Edward Millett, Hulumtuese Ligjore (AIRE Centre)

Alicia Lawson, Hulumtuese Ligjore (AIRE Centre)

Ne po ashtu falënderojmë **Katie Scarlett-Wetherall** dhe
Nevena Kostić për kontributin e tyre për këtë publikim.

© 2021 Sustineri Partners

Tirazhi 250

Versioni origjinal në gjuhën angleze është përkthyer në gjuhën
boshnjake/kroate/malazeze/serbe, shqipe dhe maqedonase

Dizajni nga Klikler Dizajn

Shtypur nga Savart M

Biznesi, të drejtat e njeriut dhe mjedisi – E ardhmja e biznesit të qëndrueshëm në Ballkanin Perëndimor

Përmbledhje ekzekutive

Dekadat e fundit kanë parë ndryshime të thella në perceptimin e rolit dhe përgjegjësisë së bizneseve për të garantuar standardet e të drejtave të njeriut dhe ato mjedisore. Mekanizmat ‘e buta’ ligjore siç janë Parimet Udhëheqëse të Kombeve të Bashkuara për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut (ang. UNGPs) tani janë përbërës thelbësorë, jo vetëm të përgjegjësive sociale korporative të kompanive, por edhe të peizazhit ligjor. Ato ushtrojnë ndikim mbi zinxhirët e furnizimit, prokurimin, pajtueshmërinë financiare dhe në strategjitë e investimit në çdo sektor komercial. Në të njëjtën kohë, shumë korporata po njohin gjithnjë e më shumë ‘vlerën e shtuar’ të këtij aspekti të veçantë. Benefitet në aspektin e fitimprurjes, rezistencës dhe qëndrueshmërisë afatgjate të zinxhirëve globalë të vlerave ofrojnë mundësi të shumta që bizneset të bëjnë më shumë dhe ta bëjnë ‘më mirë’.

Ky punim shtjellon pikërisht këto ndryshime. Ai ofron një shikim të gjerë mbi peizazhin rregullativ për bizneset dhe të drejtat e njeriut – në nivel ndërkombëtar, kombëtar, dhe në nivel të Ballkanit Perëndimor – dhe paraqet argumentet e biznesit për pajtueshmëri më të madhe të korporatave me standardet e të drejtave të njeriut dhe ato mjedisore. Ai mëton ta ngrejë këtë çështje komplekse për diskutim me qeveritë, bizneset dhe shoqërinë civile në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke pasur parasysh nevojën urgjente për respektim të standardeve ndërkombëtare të qëndrueshme të biznesit. Vetëdijesimi dhe angazhimi maksimal janë të rëndësishëm thelbësorë me qëllim të rritjes së tregtisë, uljes së papunësisë

dhe krijimit të mundësive për pjesëmarrje në ekonomitë globale dhe ato të BE-së.

Ky punim është i pari i llojit të vet, dhe do të ndiqet nga një seri punimesh të ngjashme të natyrës tematike që trajtojnë çështje të veçanta nga agjenda për fushën e biznesit, të drejtat e njeriut dhe mjedisin (ang. BHRE). Kjo seri punimesh synon të shtrojë rrugën për vlerësime më të thella të kornizave ligjore, të politikave dhe atyre institucionale, si dhe praktikave përkatëse në gjashtë juridiksionet e Ballkanit Perëndimor (WB6). Po ashtu, ai synon t'i ndihmojë këto vende të lundrojnë nëpër rregullativën ligjore të re dhe gjithnjë e më komplekse, të eksplorojnë partneritete strategjike dhe të vjelin përfitimet përkatëse.

Rregulloret ndërkombëtare dhe vendore

Instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut zakonisht janë detyruese për shtetet dhe vetëm brenda juridiksioneve të tyre. Megjithatë, kjo qasje tradicionale është sfiduar nga një trend i përsheptuar i njohjes së rolit të bizneseve në përmbushjen e detyrimeve të tyre në këto marrëveshje. Përveç kësaj, detyrimet e të drejtave të njeriut kanë filluar të shtrihen në mënyrë jashtë-territoriale edhe në veprimtarinë kombëtare të korporatave.

Iniciativat ligjvënëse vendase i plotësojnë këto trende ndërkombëtare, duke krijuar një ambient rregullativ gjithnjë e më kompleks për aktorët e korporatave. Në Mbretërinë e Bashkuar, Australi, Francë, Holandë, Gjermani dhe Norvegji tashmë janë miratuar ligje që vendosin obligime detyruese mbi aktorët korporativë në lidhje me standardet e të drejtave të njeriut dhe ato mjedisore në zinxhirin e tyre të vlerave. Direktiva e ardhshme e BE-së për zellin e duhur (due diligence) në aspektin e mjedisit dhe të drejtave të njeriut (ang. HRDD) pritet që ta konsolidojë këtë paketë ligjesh vendase në një standard më koherent tërë-rajonal. Direktiva e propozuar kërkon që shtetet anëtare të zbatojnë 'zellin e duhur efektiv' (effective due diligence) të kompanive, përfshirë detyrimet për të identifikuar, parandaluar, ndërmjetësuar dhe lehtësuar dëmtimet e të drejtave të njeriut përmes zinxhirit të vlerave. Kështu, impakti do të ndihet përtej kufijve të

juridiksioneve legjislativë. Çdo ent që zhvillon biznes, ose synon të merret me biznes, në kuadër të kompanive të vendosura në BE, do të shohë se praktikata e tij të të drejtave të njeriut dhe ato të qëndrueshmërisë do t'i nënshtrohen këqyrjes gjithnjë e më të madhe.

Trendet e proceseve gjyqësore

Gjykatat vendase dhe ndërkombëtare gjithnjë e më shumë janë të gatshme të kërkojnë llogari nga korporatat dhe shtetet për shkelje të të drejtave të njeriut dhe për degradim të mjedisit. Kryesisht, shumë detyrime 'të buta' fillimisht jodetyruese që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me bizneset, siç janë UNGPs, janë duke u forcuar efektivisht përmes proceseve gjyqësore që po paraqiten gjithnjë e më shumë në gjykatat vendase, me ndikim dhe pasoja konkrete tek llogaridhënia e bizneseve.

Në mënyrë të veçantë në Evropë ka nisur një valë procesesh gjyqësore që synon të qartësojë përgjegjësinë e përbashkët të shteteve dhe bizneseve për mbrojtje nga dëmet ndaj të drejtave të njeriut dhe, më tej, lidhjen mes të drejtave të njeriut dhe ndryshimeve klimatike. Në dy çështje të ndara në Holandë, gjykatat së pari e gjetën shtetin holandez (*Fondacioni Urgenda kundër Shtetit të Holandës*) dhe më pas Royal Dutch Shell (*Milieudefensie dhe të tjerë kundër Royal Dutch Shell*) përgjegjës për dështimin për të vepruar në lidhje me ndryshimet klimatike. Duke u mbështetur në Marrëveshjen e Parisit, vendimi në çështjen e parë ishte vendimi i parë në botë i marrë nga një gjykatë që urdhëronte një shtet që të kufizonte emetimin e gazrave serrë për arsye që nuk janë pjesë e mandateve statutores. Vendimi në çështjen e dytë arriti në përfundimin që, sipas Parimeve Udhëheqëse të UNGPs dhe OECD për Ndërmarrjet Shumëkombëshe, korporatat kanë përgjegjësinë që të respektojnë të drejtat e njeriut, pavarësisht nëse shtetet ndërmarrin veprime apo jo. Në çështjen *Chowdury dhe të tjerë kundër Greqisë*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) e mbajti shtetin grek përgjegjës për shkeljen e ndalimit të punës së detyruar nga ana e aktorëve të sektorit privat. Një çështje e katërt që është duke u përgatitur nga gjashtë fëmijë dhe të rinj/reja portugezë/e kundër 33 Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës do të

jetë çështja e parë shprehimisht e lidhur me ndryshimet klimatike që del para GjEDNj-së. Nëse ka sukses, detyra e shteteve për t'u kujdesur dhe për të mbrojtur jetën do të përfshijë edhe reduktimin e emetimeve. Kjo do të ketë ndikim indirekt të konsiderueshëm tek bizneset.

'Argumentet e biznesit' për standardet e ngritura të zellit të duhur (due diligence) për të drejtat e njeriut

Shtytësit komerciale që bizneset të zbatojnë standarde të përmirësuara në zellin e duhur për të drejtat e njeriut janë pozitivë dhe negativë. Shtytësit negativë, apo faktorët e bazuar në ndëshkime, përfshijnë shmangien e risqeve ligjore, financiare dhe atyre të reputacionit. Siç është përshkruar, rregullat e reja vendase dhe në nivel të BE-së në Evropë zbatohen në formë jashtë-territoriale nëpër zinxhirët e vlerave. Për ato kompani në Ballkanin Perëndimor që ofrojnë mallra dhe shërbime për konsumatorët e BE-së dhe konsumatorët komerciale të BE-së, dhe zinxhirin e tyre të furnizimeve të mëtejme, ky është një shtytës mjaft i rëndësishëm drejt standardeve të përmirësuara. Për shembull, Ligji gjerman për Zellin e Duhur (due diligence) në Zinxhirët e Furnizimit zbatohet si për produktet ashtu edhe për shërbimet, në çdo lokacion, për çdo kompani që punëson 3000 punonjës në Gjermani. Shtytësit pozitivë, apo faktorët e bazuar në nxitje, përfshijnë mundësitë për të ngritur ose përmirësuar reputacionin rajonal dhe atë global, për të zgjeruar biznesin, për të siguruar hua dhe investime, për të shtuar produktivitetin dhe fitimet afatgjata, dhe për të tërhequr dhe mbajtur punonjësit e përkushtuar. Duke parë provat gjithnjë në rritje që tregojnë lidhjen mes kushteve të mira të punës, produktivitetit dhe fitimprurjes, është e qartë se bizneset që ndjekin një agjendë të 'vet-interesit të përndritur' shohin përfitime të konsiderueshme falë praktikave më të qëndrueshme të biznesit. Po ashtu, ato përfitojnë nga qasja më e madhe në investime. Hulumtimet e zhvilluara nga Bloomberg tregojnë se në kuartin e parë të vitit 2020, produktet e investimeve të qëndrueshme patën më shumë sukses në treg në krahasim me produktet që nuk u përmbaheshin standardeve të Qeverisjes Sociale Mjedisore (ang. ESG). Qartazi investime të tilla konsiderohen aq rezistente sa t'u bëjnë ballë periudhave të pasigurisë së madhe ekonomike: ato fuqizojnë

bazat e operacioneve të zinxhirit të furnizimit, janë faktor dhe mbrojtës të ekspozimit ndaj rreziqeve klimatike, dhe preferojnë një qasje më afatgjatë.

Gjithnjë e më shumë, investimi në ESG është gjithashtu në ligj. Paketa më e njohur rishtaz e rregullave në këtë drejtim është Rregullorja e BE-së për Zbulimin e Qëndrueshëm të Financave (ang. SDFR). Ajo kërkon që këshilltarët financiarë, menaxherët e aseteve, bankave, dhe pjesëmarrësit e tjerë në treg të zbulojnë informacionet përkatëse të lidhura me ESG nëpër firma. Megjithatë, ka edhe mijëra investitorë që kanë vendosur standarde vullnetare. Parimet e Investimit të Përgjegjshëm (ang. PRI) dhe Task Forca për Zbulimin e Qëndrueshëm të Financave lidhur me Klimën (ang. TCFD) janë vetëm dy prej mekanizmave më me ndikim. Sërish, ky është vet-interes i përndritur. Institucionet financiare kanë filluar të njohin se 'risiku klimatik është risk biznesor', dhe që rreziqet në aspektin e reputacionit gjatë menaxhimit të investimeve që dëmtojnë njerëzit, planetin dhe reputacionet thjesht nuk ia vlejnë.

Shikim i përgjithshëm mbi kontekstin e Ballkanit Perëndimor

Ekziston nevoja urgjente për të parë se si bëhen operacionale standardet e lartcekura në juridiksionet e Ballkanit Perëndimor. Këto juridiksione përballen me presione të vazhdueshme për të harmonizuar ligjet e tyre me *acquis* të BE-së. Përveç kësaj, Agjenda e Gjelbër dhe Mekanizmi për Rregullimin e Karbonit në Kufi të miratuar së fundi për Ballkanin Perëndimor do të kenë impakt të konsiderueshëm tek bizneset në rajon. Për shkak të shifrave të larta të papunësisë në rajon, thithja e investimeve të huaja është caktuar si prioritet në nivel të politikave shtetërore. Për pasojë, firmat në rajon do të fitojnë shumë nga inkorporimi i agjendës BHRE në planifikimin e tyre komercial në mënyrë që të vazhdojnë të tërheqin investimet e huaja. Në fund, shembujt e shumtë të skandaleve publike dhe çështjeve mbi bazat e të drejtave të njeriut dhe mjedisit në rajon janë përkujtues të zymtë të faktit se vëmendja e pamjaftueshme ndaj impaktit të bizneseve mbi të drejtat e njeriut dhe mjedisin mund të rezultojnë me trazira shoqërore dhe destabilitet politik. Njëkohësisht, prania në rajon e investitorëve të mëdhenj shumëkombësh të cilët vullnetarisht iu përmbahen praktikave më të mira,

si dhe investimet e kushtëzuara të BE-së në rajon, krijojnë hapësirë për integrim dhe zbatim më të gjerë të standardeve mjedisore dhe të drejtave të njeriut.

Përfundime dhe rruga përpara

Po bëhet gjithnjë më e qartë lidhja mes nevojës për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e njeriut dhe mjedisin, nga njëra anë, dhe ambientit të tanishëm global komercial, nga ana tjetër. Kjo është kërkesë si e konsumatorëve ashtu edhe e investitorëve, e njëkohësisht është mënyrë për të de-rrezikuar zinxhirët e furnizimit dhe investimet në një kohë pasigurie të madhe nga kërcënimet gjeopolitike, ndryshimet klimatike dhe Covid-19. Po ndodh një lëvizje gjithnjë në rritje që e sheh mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe mjedisit në përputhje me, e madje kriter për, sukses komercial.

Ka prova të bollshme nga praktikatat e bizneseve që tregojnë se qasja komerciale me udhëheqje të qëndrueshme është sigurisht e mundur dhe përfaqëson të ardhmen e tregtisë globale. Është e qartë se treni drejt mbrojtjes së detyrueshme dhe më të përhapur tashmë është në lëvizje. Fitimet apo humbjet e bizneseve nga ky fakt do të varen nga momenti që ato zgjedhin për të hipur në tren. Ato që ndërmarrin praktika të mira që në fillim dhe në mënyrë vullnetare do ta kenë tranzicionin me më pak kosto dhe do të gëzojnë mundësi e avantazhe të shumta konkurruese. Kompanitë dhe shtetet që vazhdojnë ta injorojnë këtë trend e bëjnë këtë në dëm të tyre.

Përmbajtja

1. Hyrje	13
2. Korniza Rregullative e Biznesit dhe të Drejtave të Njeriut	18
E drejta ndërkombëtare	18
Drafti i Traktatit të OKB-së për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut dhe Direktiva e ardhshme e BE-së për zellin e duhur (due diligence) për mjedisin dhe të drejtat e njeriut	21
Ligji i butë	22
Legjislacioni vendor në Evropë	28
Biznesi dhe proceset gjyqësore për të drejtat e njeriut	29
3. Argumentet për respektimin e të drejtave të njeriut.....	32
Shtytësit e ndryshimit komercial.....	32
Shtytësit negativë / të bazuar në ndëshkime	32
Shtytësit pozitivë / të bazuar në nxitje	35
Shërbimet financiare	40
Listat e përjashtimeve	45
4. Konteksti rajonal: Biznesi, të drejtat e njeriut dhe mjedisi në Ballkanin Perëndimor	47
5. Përfundime	53
Lista e shkurtesave	55



1. Hyrje

‘Zhvillimi i qëndrueshëm’ është bërë fjalë kryesore e cila gjithnjë e më shumë po përhapet dhe formëson kulturën dhe vendimmarrjen institucionale dhe korporative. 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), të artikuluar nga të gjitha shtete anëtare të Kombeve të Bashkuara (OKB) në vitin 2015, përcaktojnë një sërë qëllimesh të përbashkëta që synohet të arrihen deri në vitin 2030. Realizimi i suksesshëm i këtyre objektivave mbështetet në vetë politikat dhe kornizat kombëtare të zhvillimit të qëndrueshëm të vendeve, ku të gjitha palët e interesuara, përfshirë edhe sektorin privat dhe shoqërinë civile, pritet të kontribuojnë në realizimin e agjendës së zhvillimit të qëndrueshëm.

Kështu, biznesi dhe të drejtat e njeriut, duke përfshirë edhe mbrojtjen e mjedisit (BHRE), është bërë një fushë që ka nisur të lulëzojë, me legjislacion të ri dhe vendime gjyqësore që po zhvillohen me shpejtësi. Në nivelin ndërkombëtar, janë duke u zhvilluar nisma për miratimin e Traktatit të OKB-së për Biznes dhe të Drejta të Njeriut^[1] dhe Direktivës së Bashkimit Evropian (BE) për zellin e Duhur (ang. due diligence) të korporatave^[2]. Në nivel të vendeve, legjislacioni që vendos obligime detyruese për korporatat në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut në zinxhirët e tyre të vlerave është miratuar në Mbretërinë e Bashkuar, Australi, Francë, Holandë dhe së fundmi në Gjermani dhe Norvegji. Pra, dhjetë nga trembëdhjetë shtetet që ose e kanë diskutuar ose e kanë miratuar legjislacionin e detyrueshëm për zellin e duhur (due diligence) janë anëtare të BE-së^[3]. Krahas këtyre nismave legjislative, gjykatat vendore dhe ndërkombëtare janë treguar vazhdimisht të gatshme t’i

- 1 Sapo është publikuar Drafti i tretë i rishikuar i Traktatit dhe do të shërbejë si bazë për negociata të drejtpërdrejta thelbësore ndërqeveritare të udhëhequra nga shtetet gjatë seancës së shtatë të grupit të hapur punues ndërqeveritar për korporatat transnacionale dhe ndërmarrjet e tjera të biznesit lidhur me të drejtat e njeriut, që u mbajt në tetor të vitit 2021.
- 2 Parlamenti Evropian miratoi tekstin (P9TA(2021)0073), 10 mars 2021.
- 3 Njëmbëdhjetë, përfshirë Mbretërinë e Bashkuar.


mbajnë përgjegjëse si korporatat ashtu edhe shtetet për shkeljet e të drejtave të njeriut dhe për degradimin mjedisor që rezulton nga aktivitetet e korporatave. Sërish, janë gjykatat vendore në shtetet evropiane ato që po i prijnë këtij trendi. Kohëve të fundit, Gjykata e Lartë holandeze ka konstatuar se politika e Royal Dutch Shell për qëndrueshmërinë nuk ishte ‘konkrete’ sa duhet, dhe urdhëroi që zvogëlimi i emetimeve nga korporata Shell dhe furnizuesit e blerësit e saj duhet të jetë në përputhje me Marrëveshjen e Parisit për klimën.^[4] Në Mbretërinë e Bashkuar (ang. UK), Gjykata Supreme ka vendosur që një padi kundër korporatës Shell, e ngritur nga dy komunitete nigeriane të prekura nga ndotja e naftës, mund të vazhdojë të procedohet në gjykatat angleze.^[5]

Krahas këtyre trendeve rregullative dhe të jurisprudencës, mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe mjedisit janë ngritur me shpejtësi në agjendën e bizneseve dhe investitorëve në mbarë botën. Investimet e bazuara në aspektin mjedisor, social dhe qeverisës (ang. ESG) kanë pasur një rritje eksponenciale nga viti 2011 (shih Figurën 1). Deri në vitin 2025, pasuritë e vlerësuara të qëndrueshme që i përmbushin normat e reja mjedisore, sociale dhe të qeverisjes do të përbëjnë një të tretën e *të gjitha pasurive të zotëruara në nivel global* – rreth 50 trilionë dollarë.^[6] Praktikrat e qëndrueshme të biznesit qartazi kanë lëvizur me shpejtësi nga Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së për t’u bërë pjesë thelbësore e peizazhit bashkohor të biznesit.

4 Rasti *Milieudefensie dhe të tjerë kundër Royal Dutch Shell* [2021] C / 09/571932 / HA ZA 19-379.

5 Rasti *Okpabi dhe të tjerë kundër Royal Dutch Shell Plc dhe një tjetër* [2021] UKSC3.

6 Blackrock, “Investimi i qëndrueshëm: qëndrueshmëri mes pasigurisë” (mars 2020).



Shënim rreth shpjegimit: Mbi bazën e kategorive të fondeve të përbashkëta të planifikuara për investorët institucionalë. Burimet e të dhënave: STEELE Mutual Fund Export, Morningstar, të plotësuara sipas hulumtimit dhe analizës së zhvilluar nga Sustainable Research and Analysis LLC; prospekte të fondeve dhe dokumente të tjera të ndërlidhura.

Figura 1. Burimi: Sustainableinvest.com ^[7]

Rrjedhimisht, dy dekadat e fundit kanë sjellë një ndryshim të rëndësishëm në perceptimet mbi rolin dhe përgjegjësinë e aktorëve të ndryshëm në garantimin e të drejtave të njeriut. Instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të hartuara kryesisht nga vitet 1950' e këndej, kanë vënë detyrime direkte mbi shtetet. Sidoqoftë, ndonëse në fund të fundit shtetet janë përgjegjëse për respektimin e këtyre instrumenteve, gjithnjë e më shumë është duke u kuptuar se respektimi i të drejtave të njeriut nuk është përgjegjësi ekskluzive e shteteve.^[8]

Për më tepër, mekanizmat e pranuar ndërkombëtarisht si Parimet Udhëheqëse të OKB-së për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së tani i japin formë praktikave të biznesit të korporatave të mëdha shumëkombëshe dhe gjithnjë e më shumë edhe të partnerëve të tyre tregtarë, nënkontraktuesve dhe filialeve

7 Sustainableinvest.com, *Një dekadë e Investimit të Qëndrueshëm të Fondeve: 10 vite/10 grafikë* <https://www.sustainableinvest.com/sustainable-investing-decade/>

8 Shihni më poshtë një përmbledhje të kornizave legjislative të vendeve.

në zinxhirin global të vlerës. Derisa këta mekanizma paraqesin ‘ligjin e butë’ jo-detyrues, ato po forcohen gradualisht nëpërmjet proceseve gjyqësore dhe reformave legjislative për t’i përfshirë ato në ligjet kombëtare. Kështu, në vendimin e sipërpërmendur të Gjykatës së Lartë Holandeze kundër Shellit, gjykata arriti në përfundimin se në bazë të UNGP-ve dhe Udhëzimeve të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (ang. OECD), korporatat kanë përgjegjësinë për të respektuar të drejtat e njeriut pavarësisht nëse shtetet ndërmarrin veprime apo jo.

Prandaj, ndryshimi i perceptimeve për rolin dhe përgjegjësinë e bizneseve për të garantuar të drejtat e njeriut nuk ka ndodhur vetëm në Strasburg, Nju Jork dhe Gjenevë, por edhe në zyrat e drejtuesve të kompanive, në supermarkete dhe në vendet e punës në mbarë botën. Respektimi i të drejtave të njeriut është bërë pjesë përbërëse për konsumatorët, prodhuesit, furnitorët, aksionarët dhe drejtorët, po aq sa edhe për politikëbërësit dhe ligjvënësit. Kjo tregon për një ndryshim gjithnjë e më të madh, por të pakthyeshëm, drejt kërkesës për zhvillim ekonomik global të përgjegjshëm në aspektin social dhe mjedisor.

Pavarësisht nga këto zhvillime globale, agjenda e BHRE-së deri më sot ka marrë pak vëmendje në Ballkanin Perëndimor, si nga qeveritë ashtu edhe nga sektori privat. Janë të pakta nismat në rajon që përpiqen të adresojnë çështjen e praktikave të qëndrueshme të biznesit në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe kuptimplote. Megjithatë, ekziston një nevojë urgjente për t’u përfshirë në këtë bisedë, duke marrë parasysh rritjen e vetëdijesimit për ndikimin e bizneseve në komunitete, dhe përgjegjësinë si të qeverive ashtu edhe të bizneseve për të menaxhuar dhe kontrolluar një ndikim të tillë. Në dritën e trendeve globale në fushën e biznesit, të drejtave të njeriut dhe mjedisit, të trajtuara në këtë punim, dhe numrit në rritje të bizneseve që e kanë përkrahur këtë agjendë – qoftë për shkak të rritjes së presionit rregullativ, “presionit të bizneseve të tjera” apo interesit të perceptuar vetjak – është imperativ për rajonin e Ballkanit Perëndimor që të mbaj hapin me zhvillimet e tilla globale. Fakti që këto trende po marrin vull veçanërisht në shtetet e BE-së krijon një nxitje shtesë, pasi rajoni përpiqet të rris në maksimum mundësitë e tij për tregti dhe për anëtarësim në BE.

Me qëllim të hapjes së kësaj teme të rëndësishme me qeveritë, bizneset dhe shoqërinë civile, do të bëhen një sërë punimesh tematike që trajtojnë çështje të veçanta në lidhje me biznesin, të drejtat e njeriut dhe mjedisin në bashkëpunim me organizatat dhe ekspertët e përfshirë në këtë studim. Dokumentet tematike do të fokusohen në çështje si standardet e punës, mbrojtja e mjedisit, barazia gjinore, privatësia, e drejta për shëndet, etj. Këto studime tematike do të paraqesin dhe shpjegojnë standardet përkatëse ndërkombëtare, praktikën krahasuese dhe trendet e reja që kanë të bëjnë me këtë temë specifike. Studimet do të përpiqen të identifikojnë sfidat kryesore dhe të ofrojnë një bazë për vlerësim më të plotë të kornizës ligjore, politike dhe institucionale dhe praktikës relevante në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (BB6) për t'i ndihmuar ato të 'lundrojnë' në këtë fushë ligjore dhe rregullative të ndërlikuar e cila po zhvillohet me shpejtësi.^[9]

Duke marrë parasysh ritmin e shpejtë të zhvillimeve në këtë fushë, secili studim tematik do të bëhet në bashkëpunim me një sërë palësh të interesuara në rajonin e Ballkanit Perëndimor, me synimin që udhëheqësit e biznesit dhe politikëbërësit të njihen me këtë çështje të spikatur globale dhe me rëndësinë e saj gjithnjë e më të madhe për praktikën bashkëkohore të biznesit dhe politikëbërjen. Shpresohet se puna në studimet tematike dhe në aktivitete për të promovuar ato do të iniciojnë partneritete ndërmjet aktorëve përkatës ndërkombëtarë dhe vendorë për ta vënë këtë çështje në qendër të vëmendjes së publikut dhe për të hulumtuar mundësinë për bashkëpunim në iniciativa specifike në të ardhmen. Ky punim i tanishëm është i pari nga një seri punimesh dhe jep një përmbledhje të agjendës së biznesit dhe të të drejtave të njeriut, zhvillimet kryesore dhe kornizat përkatëse, si dhe argumentet për respektimin e të drejtave të njeriut.

Në pjesën tjetër të këtij punimi, ne ofrojmë një përmbledhje të peizazhit rregullativ të biznesit dhe të drejtave të njeriut - përfshirë instrumentet ligjore ndërkombëtare, ligjin e butë dhe trendet e proceseve gjyqësore - para se të shqyrtojmë 'argumentimin' për ngritjen e standardeve të zellit të

duhur (due diligence) për të drejtat e njeriut, së bashku me një përmbledhje të kontekstit rajonal të Ballkanit Perëndimor.

2. Korniza Rregullative e Biznesit dhe të Drejtave të Njeriut

Rritja e konsiderueshme e aktivitetit legjislativ në fushën e biznesit dhe të drejtave të njeriut, përfshirë investimet e qëndrueshme/ESG, raportimet e korporatave dhe detyrimet e zinxhirit të furnizimit, paraqet një sinjal të fuqishëm të rritjes së interesimit për këtë fushë nga qeveritë dhe shoqëria në përgjithësi. Për firmat, këto çështje janë zhvilluar në mënyrë të konsiderueshme nga të qenit çështje të përgjegjësisë sociale të korporatave në çështje të pajtueshmërisë rregullative dhe janë bërë thelbësore për identitetin dhe reputacionin korporativ të firmave.

E drejta ndërkombëtare

Traktatet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut obligojnë kryesisht *shtetet, e jo bizneset apo organizatat* për të siguruar të drejtat individuale të njeriut të personave brenda juridiksionit të tyre. Sipas Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ang. ICCPR), shtetet anëtare duhet, për shembull, të ndalojnë skllavërinë/punën e detyruar (neni 8) dhe të mbrojnë të drejtën e lirisë së bashkimit me të tjerët (neni 22), por traktati në vetvete nuk është detyrues për kompanitë që gjenden brenda shteteve.

Pakti ICESCR, i cili përcakton të drejtat themelore ekonomike, sociale dhe kulturore, rregullon të drejtat si puna (neni 6), kushtet e drejta dhe të favorshme të punës (neni 7), formimin e sindikatave dhe grevat e punëtorëve (neni 8), si dhe të drejtat për një standard adekuat të jetesës, për standardet më të larta të arritshme të shëndetit fizik dhe mendor, si dhe për arsimin dhe gëzimin e përfitimeve të lirisë kulturore dhe progresit shkencor.

Megjithatë, Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (CESCR) – një organ ekspertësh të pavarur përgjegjës për monitorimin

e zbatimit të ICESCR-së – ka pranuar shprehimisht “përgjegjësitë” e ndërmarrjeve private për realizimin e të drejtave për punë dhe për kushte të drejta dhe të favorshme të punës.^[10] Rrjedhimisht, Komenti i Përgjithshëm nr. 18 mbi të drejtën për punë thekson se “ndërmarrjet private – kombëtare dhe shumëkombëshe – ndonëse nuk janë të detyruara sipas Paktit, kanë një rol të veçantë për të luajtur në krijimin e vendeve të punës, në politikat e punësimit dhe në qasjen jodiskriminuese në punë,^[11] ndërsa Komenti i Përgjithshëm nr. 23 mbi të drejtën për kushte të drejta dhe të favorshme të punës thekson në mënyrë të ngjashme se ‘ndërmarrjet e biznesit ... kanë përgjegjësi të respektojnë të drejtën për kushte të drejta dhe të favorshme të punës, duke shmangur çdo shkelje dhe duke adresuar çdo abuzim të kësaj të drejte si rezultat i veprimeve të tyre’.^[12] Për më tepër, CESCR-ja ka theksuar se detyrimet e shteteve për të përfshirë të drejtat për punë dhe kushte të drejta dhe të favorshme të punës në legjislacionin vendor përfshijnë detyrën për të siguruar që shtetasit e korporatave të tyre t’i respektojnë këto të drejta në aktivitetet e tyre jashtë territorit të

- 10 ‘Komenti i Përgjithshëm Nr. 18 i CESCR-së: E drejta për punë (Neni 6 i Paktit)’, OKB Doc E/C.12/GC/18, (6 shkurt 2006) para. 52; CESCR, ‘Komenti i përgjithshëm nr. 23 (2016) mbi të drejtën për kushte të drejta dhe të favorshme të punës’, OKB Doc E/C.12/GC/23 (27 Prill 2016) para. 74–75. Shih po ashtu Parimet Udhëzuese të OKB-së për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, parimet 11, 12, 22 dhe 23. CESCR ka publikuar kohëve të fundit “Komentin e Përgjithshëm nr. 24 (2017) mbi detyrimet e shtetit sipas ICESCR-së në kontekstin e aktiviteteve të biznesit”, OKB Doc. E/C.12/GC/24 (10 gusht 2017), ku e përforcojë qëndrimin e saj të mëhershëm se “[komenti i përgjithshëm aktual u drejtohet shteteve anëtare të Paktit dhe në këtë kontekst ai ka të bëjë me sjelljen aktorëve privatë – përfshirë subjektet e biznesit – vetëm në mënyrë indirekte’. Megjithatë, në të njëjtin dokument thuhet gjithashtu se “sipas standardeve ndërkombëtare, subjektet e biznesit priten të respektojnë të drejtat e Paktit, pavarësisht se a ekzistojnë ligjet vendore ose se a zbatohen ato plotësisht në praktikë”.
- 11 ‘Komenti i Përgjithshëm Nr. 18 i CESCR-së: E drejta për punë (Neni 6 i Paktit)’, OKB Doc E/C.12/GC/18, (6 shkurt 2006) para. 52.
- 12 CESCR, ‘Komenti i përgjithshëm nr. 23 E drejta për kushte të drejta dhe të favorshme të punës’, OKB Doc E/C.12/GC/23 (27 prill 2016) para. 75.

vendit.^[13] Kjo sinjalizon një largim nga pikëpamja tradicionale se detyrimet ndërkombëtare të shteteve zbatohen vetëm brenda juridiksionit të tyre territorial. Arsyetim i ngjashëm përdoret edhe në lidhje me të drejtat e tjera të ICESCR-së, siç është e drejta për ushqim, e drejta për shëndet ose e drejta për ujë,^[14] si dhe nga organet e tjera të traktatit të OKB-së.^[15]

Përtej instrumenteve të përgjithshme të të drejtave të njeriut, një gamë e gjerë instrumentesh trajtojnë çështje specifike që janë me rëndësi për bizneset në fusha të ndryshme tematike. Këto përfshijnë konventat e hartuara nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), të cilat janë të rëndësishme për rregullimin e marrëdhënieve të punës, një fushë kyçe për respektimin e të drejtave komerciale të njeriut,^[16] Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punëtorëve Emigrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) e të tjera.

-
- 13 'Komenti i Përgjithshëm Nr. 18 i CESC-së: E drejta për punë (Neni 6 i Paktit)', OKB Doc E/C.12/GC/18, (6 shkurt 2006) para. 30; CESC, 'Komenti i përgjithshëm nr. 23 (2016) mbi të drejtën për kushte të drejta dhe të favorshme të punës', OKB Doc E/C.12/GC/23 (27 Prill 2016) para. 70.
- 14 Shih CESC, 'Komenti i Përgjithshëm Nr. 24 (2017) mbi Detyrimet e shtetit sipas ICESCR në kontekst të aktiviteteve të biznesit', OKB Doc. E/C.12/GC/24 (10 gusht 2017) para. 25-37.
- 15 Komiteti i CRC-së, 'Komenti i Përgjithshëm Nr. 16 (2013) mbi Detyrimet e shtetit lidhur me ndikimin e sektorit të biznesit në të drejtat e fëmijëve', OKB Doc. CRC/C/GC/16 (17 prill 2013) para. 38-46.
- 16 Tetë konventat themelore të punës të ILO-s janë: Konventa për lirinë e tubimit dhe mbrojtjen e të drejtës për organizim, 1948 (Nr. 87); Konventa për të drejtën për tu organizuar dhe për marrëveshje kolektive, 1949 (Nr. 98); Konventa mbi punën e detyrueshme, 1930 (Nr. 29) (dhe Protokollin i saj i vitit 2014); Konventa për eliminimin e punës së detyruar, 1957 (nr. 105); Konventa për moshën minimale, 1973 (nr. 138); Konventa për format më të këqija të punës së fëmijëve, 1999 (nr. 182); Konventa për pagesë të barabartë, 1951 (Nr. 100); Konventa mbi diskriminimin (punësimi dhe profesioni), 1958 (Nr. 111).

Drafti i Traktatit të OKB-së për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut dhe Direktiva e ardhshme e BE-së për zellin e duhur (due diligence) për mjedisin dhe të drejtat e njeriut

Që nga viti 2014, kanë vazhduar negociatat lidhur me Traktatin për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut të Këshillit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, drafti i tretë i të cilit u publikua në vitin 2021.^[17] Traktati do të kërkojë detyrimisht të tregohet zelli i duhur (due diligence) për të drejtat e njeriut në nivel ndërkombëtar, do të forconte mekanizmat korrigjues për viktimat dhe do tu jepte UNGP-ve një bazë më të fuqishme legjislative – një sinjal tjetër i trendit global të kalimit nga kornizat e ‘ligjit të butë’ në instrumente të ‘ligjit të fortë’ që rregullojnë aktivitetet e ndërmarrjeve private në fushën e të drejtave të njeriut. Megjithatë, shumë shtete përfshirë SHBA-në, BE-në dhe Britaninë e Madhe janë tërhequr nga procesi i negociatave duke përmendur disa mangësi themelore në qasje, që do të thotë se ekziston rreziku që Traktati të mos finalizohet kurrë. Sidoqoftë, negociatat tregojnë shkallën e interesimit në nivel global për rregullimin e sjelljes së biznesit lidhur me të drejtat e njeriut, edhe pse tani ka mundësi që të arrihet një progres më i madh legjislativ në nivel vendor dhe rajonal.

Për shembull, BE-ja është duke zhvilluar legjislacion specifik në këtë fushë. Krahas programit legjislativ të BE-së në lidhje me financimin e qëndrueshëm të përshkruar në seksionin 3 më poshtë, ka disa lëvizje në nivel të BE-së drejt një sërë rregullash për zellin e duhur (due diligence) mjedisor dhe për të drejtat e njeriut. Teksti i një projektdirektive tani është miratuar nga Parlamenti Evropian për një ligj që do të kërkonte ‘zell të duhur efektiv’ nga firmat në lidhje me të drejtat e njeriut, mjedisin dhe qeverisjen e mirë. Sipas projektligjit, firmave do t’u kërkohet të zbatojnë mekanizmat e brendshëm të ankesës dhe një strategji të zellit të duhur (due diligence) që adreson këto çështje: specifikimin e ndikimeve negative ekzistuese ose të mundshme në të drejtat e njeriut; hartëzimin e zinxhirit të vlerës dhe shpalsjen e informacioneve përkatëse (emrat, vendndodhjet, produktet, furnitorët, filialet, partnerët e biznesit); miratimin dhe përcaktimin e

politikave dhe masave për të parandaluar ose zbutur ndikimet në të drejtat e njeriut; krijimin e një strategjie të priorizimit kur nuk mund të adresohen të gjitha ndikimet negative njëkohësisht; dhe krijimin e politikave të duhura, marrëveshjeve kornizë, klauzolave kontraktuese, kodeve të sjelljes dhe auditimeve^[18]. Shkalla e lartë e mbështetjes publike për një legjislacion të tillë duhet të shërbejë si nxitje për bizneset që të integrojnë praktika të tilla sa më shpejt.^[19]

Ligji i butë

Shumica e instrumenteve ligjore ndërkombëtare rregullojnë veprimtarinë e shteteve, çka mund të çojë në një hendek të madh në mes të detyrimeve të shteteve sipas të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në njërën anë dhe detyrimit të bizneseve që operojnë në territore të tilla, në anën tjetër. Në mungesë të legjislacionit vendor, mekanizmat e ligjit të butë synojnë të kapërcejnë këtë hendek duke vendosur standarde që duhet t'i respektojnë dhe zbatojnë kompanitë pavarësisht se ku operojnë.

Parimet më të rëndësishme nga këto janë Parimet Udhëzuese të OKB-së për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut (UNGP), të miratuara në vitin 2011 nga Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, të cilat mbeten standardi i artë për përcaktimin e përgjegjësive të firmave për të drejtat e njeriut. UNGP-të mbështeten në tri shtylla: 'Korniza e mbrojtjes, respektimit dhe korrigjimit'.

18 Teksti i miratuar nga Parlamenti Evropian (P9_TA(2021)0073), 10 mars 2021.

19 Koalicioni Evropian për Drejtësi Korporative, "Mbështetje e jashtëzakonshme publike për ligjin e BE-së për t'i mbajtur kompanitë përgjegjëse për shkeljet e të drejtave të njeriut dhe dëmet mjedisore" (13 tetor 2021) në dispozicion në: <https://corporatejustice.org/news/poll-shows-overwhelming-public-support-for-eu-law-to-hold-companies-liable/>.

Korniza e mbrojtjes, respektimit dhe korrigjimit 2008

- Shtetet kanë përgjegjësi për të **mbrojtur** të drejtat e njeriut kundër abuzimit nga palët e treta, përfshirë biznesin, përmes politikave, legjislacionit, rregulloreve dhe gjykimeve të duhura.
- Korporatat duhet të **respektojnë** të drejtat e njeriut, që do të thotë se duhet të veprojnë me zellin e duhur (due diligence) për të shmangur cenimin e të drejtave të të tjerëve dhe të adresojnë ndikimet negative me të cilat ata janë të përfshirë.
- Viktimat e abuzimit të të drejtave të njeriut që lidhen me bizneset duhet të kenë qasje në **mjete juridike** efektive, gjyqësore dhe jogjyqësore.

Sidomos, shtylla e dytë e UNGP-ve i obligon kompanitë të respektojnë të drejtat e njeriut kudo që operojnë. Sipas kësaj shtylle, aty ku ligjet kombëtare janë nën standardin e të drejtave të njeriut të njohura ndërkombëtarisht, kompanitë duhet të respektojnë standardin më të lartë. Kur këto standarde më të larta bien ndesh me ligjet kombëtare, kompanitë duhet prapë të kërkojnë mënyra për të respektuar parimet e atyre standardeve brenda kufijve të ligjit kombëtar.

Parimet operationale të UNGP-ve i sqarojnë në hollësi hapat praktikë që bizneset duhet të ndërmarrin për të përmbushur detyrimin e tyre për të respektuar të drejtat e njeriut. Së pari, kompanive u kërkohet të bëjnë një zotim politik (Parimi 16) në këtë drejtim. Së dyti, ato duhet të tregojnë vazhdimisht zellin e duhur (due diligence) për të drejtat e njeriut për të identifikuar, parandaluar, zbutur dhe llogaritur ndikimet e tyre në të drejtat e njeriut (Parimet 17 – 21). Së treti, ato duhet të kenë procese për të mundësuar korrigjimin e çdo ndikimi negativ në të drejtat e njeriut që ato shkaktojnë ose për të cilat kontribuojnë (Parimi 22). Prandaj, UNGP-të ofrojnë një udhëzues se si mund të veprojnë bizneset në aso mënyre

që respekton të drejtat e njeriut, duke iu përmbajtur parimeve përkatëse themelore dhe operacionale.

Pavarësisht natyrës së tyre si ‘ligji i butë’, nuk duhet nënvlerësuar pranimi dhe miratimi i gjerë i UNGP-ve nga shtetet dhe bizneset si një standard i njohur globalisht, dhe si ‘drejtim i pashmangshëm i rrugëtimit’ botëror drejt një mjedisi më të fuqishëm rregullativ për bizneset në lidhje me të drejtat e njeriut. Një mënyrë në të cilën mund të shihet ndikimi i tyre është në legjislationin e nivelit të BE-së dhe atë vendor, të

*Ligjit të butë i dalin dhëmbët:
Milieudéfensie kundër Royal
Dutch Shell [2021]*

Gjykatat holandeze iu drejtuan UNGP-ve për të gjetur obligime detyruese për Shell në lidhje me Marrëveshjen e Parisit.

Detyrimet e ligjit të butë ende u ngarkojnë bizneseve përgjegjësi konkrete.

cilat që të dyja mbështeten gjithnjë e më shumë në parimet e UNGP-ve për sa i përket detyrimeve të bizneseve për të mbrojtur, respektuar dhe korigjuar abuzimet e të drejtave të njeriut. Në një shembull të rëndësishëm të kohëve të fundit, gjykatat holandeze kanë ndërmarrë hapin e leximit të parimeve të UNGP-ve në praktikën gjyqësore të brendshme, e cila në njëfarë mënyre shkon drejt ‘forcimit’ të këtyre parimeve të ligjit të butë duke i bërë ato obligime më detyruese për kompanitë private.^[20] Në një rast tjetër, Gjykata Ndër-Amerikane e të Drejtave të Njeriut (ang. IACHR) kohëve të fundit ka përdorur UNGP-të në një rast të ngritur nga grupet indigjene kundër shtetit të Surinamit në lidhje me dhënien e licencave për miniera firmave të ndryshme private.^[21] Këto raste nuk tregojnë thjesht rëndësinë e ligjit të butë në nxitjen e pritshmërisë dhe ndërgjegjësimit. Ato janë një demonstrim se pritjet që i ka shoqëria nga bizneset janë duke u trajtuar gjithnjë e më shumë si çështje ligjore. Në të vërtetë, termi ‘licencë shoqërore për të punuar’ është integruar në instrumente të ndryshme të kohëve të fundit të Kombeve të Bashkuara për biznesin dhe të drejtat e

20 Rasti *Milieudéfensie et al. kundër Royal Dutch Shell C / 09/571932 / HA ZA 19-379*.

21 *Rasti e Popujve Kaliña dhe Lokono kundër Surinamit*, IACHR, 25 nëntor 2015.

njeriut, përfshirë UNGP-të. Kjo i jep konceptit dinamik të përgjegjesisë sociale të korporatave një kornizë ligjore.^[22]

Mekanizmi tjetër kyç i ligjit të butë janë Udhëzimet e OECD-së për Ndërmarrjet Shumëkombëshe. Të miratuara për herë të parë në vitin 1976, Udhëzimet e OECD-së janë rekomandime për ndërmarrjet shumëkombëshe (NSHK) për sjelljen e përgjegjshme të bizneseve. Ndonëse Udhëzimet e OECD-së nuk janë ligjërish të detyrueshme për kompanitë, ato janë të detyrueshme për qeveritë nënshkruese, të cilave u kërkohet të sigurohen që këto Udhëzime të zbatohen dhe respektohen. Dyzet e nëntë vende në mbarë botën u përmbahen këtyre Udhëzimeve, përfshirë shumicën e shteteve të BE/ZEE, SHBA-në, MB-në, Kanadanë, Brazilin, Turqinë dhe Korenë e Jugut. Pjesa I e Udhëzimeve të OECD-së paraqet rekomandime për bizneset që veprojnë në një shtet që i respekton të drejtat e punës, të drejtat e njeriut, mjedisin, zbulimin e informacionit, luftimin e rryshfetit, interesat e konsumatorëve, konkurrencën, tatimet dhe të drejtat e pronësisë intelektuale. Pjesa II e Udhëzimeve të OECD-së përcakton udhëzimet procedurale për zbatimin e rekomandimeve të përfshira në Pjesën I.

Udhëzimet e OECD-së po ashtu kërkojnë nga shtetet që i zbatojnë ato të krijojnë një mekanizëm të brendshëm të ankesës të mbështetur nga qeveria në formë të një Pike Kombëtare të Kontaktit (PKK). Sipas Udhëzimeve të OECD-së, çdo qeveri që i zbaton ato duhet të krijojë një PKK për të promovuar Udhëzimet e OECD-së dhe për të trajtuar ankesat kundër kompanive që pretendohet se nuk kanë vepruar në përputhje me standardet e Udhëzimeve. PKK-të mund të trajtojnë ankesat që pretendojnë shkelje të udhëzimeve të PKK-së që ndodhin ose brenda vendit të PKK-së nga një NSHK me seli kudo në botë, ose kudo në botë nga një ndërmarrje shumëkombëshe me seli në vendin e PKK-së.

22 Karin Buhman, 'Rregullatorët Publikë dhe CSR: "Licenca shoqërore për të vepruar" në Instrumentet e fundit të Kombeve të Bashkuara për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut dhe Juridifikimin e CSR-së' (2016) 136 (4) Revista e Etikës së Biznesit 699.

Në përgjithësi, Udhëzimet e OECD-së përbëjnë një mjet të rëndësishëm për shoqërinë civile për t'u angazhuar me ndërmarrjet shumëkombëshe dhe për të ekspozuar praktikat e këqija në një mjedis kuazi-ligjor të ndërmjetësuar. Ato gjithashtu mund të kenë një ndikim të rëndësishëm. Në vitin 2020, OJQ-ja ClientEarth parashtroi një ankesë përmes PKK-së se një fushatë reklamuese e BP-së kishte shkelur udhëzimet e OECD-së duke mashtruar publikun për madhësinë e biznesit të saj të burimeve të ripërtërishme. Disa muaj pas parashtrimit të ankesës, dhe para se ajo të shqyrtohej, BP-ja e tërhoqi fushatën shumë milionëshe dhe u zotua se do të ndalonte të gjitha reklamat për reputacion në të ardhmen.^[23]

Udhëzimet e ligjit të butë kanë ndikim jashtë sallës së gjyqit: Ankesa e BP OECD

OJQ-ja ClientEarth paraqiti një ankesë nëpërmjet PKK-së se fushata reklamuese e BP-së kishte shkelur udhëzimet e OECD-së duke mashtruar publikun lidhur me madhësinë e biznesit të saj të burimeve të ripërtërishme.

Para se të vlerësohej ankesa, BP e tërhoqi fushatën e saj shumë milionëshe dhe u zotua se do ndalonte të gjitha reklamat për reputacion në të ardhmen.

Ky rast demonstroi aftësinë e ligjit të butë, instrumenteve ligjore jodetyruese për të ndikuar te korporatat duke kontestuar licencën e tyre shoqërore për të vepruar. Përzjerja e pazakonshme e zbutjes së rrezikut për reputacionin nga BP-ja, e bërë në një mjedis kuazi-ligjor, ilustron se si pritjet sociale po bëhen gjithnjë e më shumë kornizë ligjore. Kjo ankesë ka frymëzuar një mori rastesh të tjera të marketingut të gjelbër manipulues (greenwashing) kundër kompanive kryesore të naftës në mbarë botën.^[24]

23 ClientEarth, 'BP tërhoq fushatën e fundit reklamuese vetëm disa muaj pas ankesës sonë ligjore' (14 shkurt 2020) në dispozicion në: <https://www.clientearth.org/latest/latest-updates/news/bp-pulls-advertising-campaign-just-months-after-our-legal-complaint/>.

24 Chris Morris dhe Merlyn Thomas, "Shteti amerikan sulmon një gjigant naftë për marketing të gjelbër manipulues" (BBC News, 6 nëntor 2021) në dispozicion në: <https://www.bbc.co.uk/news/blogs-trending-59070451>.

Drejtimi i udhëtimit është i qartë: përgjegjësia dhe pritjet e papërcaktuara sociale përfshihen në instrumentet ndërkombëtare të ligjit të butë, duke mundësuar fillimisht argumentet kuazi-ligjore, e pastaj edhe ato ligjore.

Në të njëjtën mënyrë, Udhëzimet e OECD-së, së bashku me ligjin e butë për këtë fushë në përgjithësi, janë duke i informuar gjithnjë e më shumë agjendat legislative vendore. Për shembull, projektligji i Parlamentit Evropian mbi zellin e duhur (due diligence) për të drejtat e njeriut i referohet në mënyrë eksplicite Udhëzimeve të OECD-së në preambulën e tij. Natyrisht, ndryshe nga detyrimet e të drejtës ndërkombëtare, legjislacioni vendor është drejtpërdrejt i zbatueshëm dhe detyrues për bizneset. Procesi është një proces i forcimit të ligjit të butë për të sjellë rezultate shumë reale dhe të prekshme për bizneset në terren.

Përtej këtyre mekanizmave, ekziston një gamë e gjerë mekanizmesh dhe marrëveshesh të tjera të ligjit të butë, të cilat do të hulumtohen më në detaje në punimet e ardhshme tematike, përfshirë Kompaktin Global të OKB-së, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Udhëzimet e OECD-së mbi zellin e duhur (due diligence) për sjelljen e përgjegjshme të biznesit, Parimet e Ekuatorit dhe Parimet e OKB-së për Kontratat e Përgjegjshme. Përveç kësaj, Komisioni i OKB-së për të Drejtat e Njeriut është duke u fokusuar gjithnjë e më shumë në sigurimin që marrëveshjet tregtare dypalëshe, e veçanërisht marrëveshjet ndërkombëtare të investitorëve, të vazhdojnë të përfshijnë detyrimet e biznesit për respektimin e të drejtave të njeriut, të cilat mund të preken nga kufizimet në hapësirën ligjore ose politike që kanë në dispozicion shtetet për rregullimin e sjelljes së investitorëve dhe të drejtën e komuniteteve të prekura për të kërkuar mjete juridike efektive kundër investitorëve për abuzimet e të drejtave të njeriut që lidhen me projektet.^[25]

25 OHCHR, Marrëveshjet Ndërkombëtare të Investimeve dhe të Drejtat e Njeriut, A/76/238, 27 korrik 2021.

Legjislacioni vendor në Evropë

Vitet e fundit ka filluar të vërehet zhvillimi i legjislacionit të ri vendor që rregullon veprimet e bizneseve në lidhje me të drejtat e njeriut, veçanërisht në lidhje me shkeljet brenda zinxhirëve kompleks të vlerës së ndërmarrjeve shumëkombëshe. Ky trend është në përputhje me drejtimin e udhëtimit të përcaktuar nga mekanizmat e ligjit të butë për të kapërcyer hendekun midis detyrimeve të shteteve sipas ligjit për të drejtat e njeriut dhe detyrimit të bizneseve që operojnë në territore të tilla. Nevoja për një legjislacion të tillë është bërë veçanërisht e rëndësishme ku bizneset shumëkombëshe evropiane kanë zinxhirë të gjatë dhe kompleks të vlerave, duke filluar nga ato jashtë vendit dhe duke përfunduar me konsumatorin vendor. Legjislacioni i ri përfshin seksionin 54 (*Transparenca në zinxhirët e furnizimit*) të Ligjit të Mbretërisë së Bashkuar për Skllavërinë Moderne 2015, Ligjit të Francës për Detyrën e Vigjilencës 2017, Ligjit të Holandës për Zellin e Duhur për Punën e Fëmijëve 2020 dhe Aktit të Gjermanisë për Zinxhirin e Furnizimit 2021.

Në pjesën më të madhe, legjislacioni i ri për sjelljen e përgjegjshme të bizneseve në lidhje me të drejtat e njeriut fokusohet në vendosjen e standardeve minimale për transparencën e zinxhirit të vlerës, analizën e rrezikut, zellin e duhur (due diligence), zbutjen dhe raportimin, duke aplikuar ndëshkime civile (dhe në rastin e Holandës - penale) për kompanitë që nuk marrin hapa aktivë për të hetuar, zbuluar dhe trajtuar abuzimet mjedisore dhe të të drejtave të njeriut në operacionet e tyre dhe çka është shumë me rëndësi, brenda zinxhirit të tyre të vlerës.

Megjithatë, legjislacioni i ri vendor duket kryesisht i pakoordinuar, duke krijuar pasiguri për bizneset që operojnë në juridiksione të ndryshme kur bëhet fjalë për detyrimet e tyre për të respektuar të drejtat themelore. Përveç kësaj, këto ligje ende mbështeten kryesisht tek shoqëria civile për të raportuar mbi keqpërdorimet e korporatave, për të “denoncuar publikisht” kompanitë në mënyrë që ato të veprojnë, në vend që të pajisin plotësisht rregullatorët vendorë për të hetuar dhe ndëshkuar praktikat e këqija. Për më tepër, procesi gjyqësor për delikte civile aktualisht është

mënyra kryesore me të cilën legjislacioni vendor parashikon që viktimat të arrijnë zhdëmtimin – një procedurë që kufizohet nga pengesat procedurale për paditësit që pësojnë dëme në një vend të tretë, si p.sh., e drejta e paraqitjes së kërkesës (padsisë), juridiksioni dhe problemet me provat, dhe qasja në financimin e proceseve gjyqësore. Disa nga rastet e rëndësishme të brendshme [të vendeve] diskutohen më tej më poshtë.

Biznesi dhe proceset gjyqësore për të drejtat e njeriut

Gjykatat në shumë juridiksione vendore po tregohen gjithnjë e më të gatshme t'i mbajnë bizneset përgjegjëse për shkeljet e të drejtave të njeriut që ndodhin brenda zinxhirëve të tyre të vlerës, veçanërisht në lidhje me degradimin mjedisor dhe ndryshimet klimatike. Në Holandë, në dy raste kyçe janë shpallur përgjegjës shteti holandez dhe Shelli, një korporatë e madhe energjetike, për dështimin për të vepruar ndaj ndryshimeve klimatike.^[26] Në Kanada, një kompani minerare është paditur për abuzimet e fuqisë punëtore të pësuar nga punëtorët e punësuar nga një kompani e nënkontraktuar në Eritrea të Afrikës Lindore.^[27] Në Mbretërinë e Bashkuar, një sërë vendimesh të Gjykatës Supreme kanë krijuar mundësinë që kompanitë amë me seli në Mbretërinë e Bashkuar të shpallen përgjegjëse për abuzimet e të drejtave të njeriut të kryera nga filialet dhe nënkontraktuesit e tyre jashtë vendit.^[28]

Në nivel ndërkombëtar, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) po ashtu është duke vazhduar të zhvillojë dhe zgjerojë jurisprudencën e saj në lidhje me detyrimet e shteteve për të ofruar mbrojtje kundër shkeljeve të të drejtave të njeriut që rezultojnë nga aktivitetet e korporatave si brenda territorit të shtetit^[29] ashtu edhe në kontekstin e ndërmarrjeve shtetërore

-
- 26 Rasti *Fondacioni Urgenda kundër Shtetit të Holandës* [2015] HAZA C/09/00456689; Rasti *Milieudefensie et al. kundër Royal Dutch Shell* [2021] C/09/571932 / HA ZA 19-379.
- 27 Rasti *Nevsun Resources Ltd kundër Araya*, [2020] SCC 5.
- 28 Rasti *Vedanta Resources Plc dhe një tjetër kundër Lungowe dhe të tjerëve* [2019] UKSC 20; Rasti *Okpabi dhe të tjerët kundër Royal Dutch Shell Plc dhe një tjetri* [2021] UKSC 3.
- 29 Rasti *Lopez Ostra kundër Spanjës* (Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994); Rasti *Guerra dhe të tjerët*

jashtë vendit.^[30] Në fushën e degradimit të mjedisit dhe ndryshimeve klimatike, një kërkesë e kohëve të fundit nga një grup prej gjashtë fëmijësh dhe të rinjsh portugez kundër 33 shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, nëse do të jetë e suksesshme, do të ketë pasoja të rëndësishme për bizneset. Kërkesa përfshin pretendimet se 33 shtetet anëtare kishin shkelur obligimet e tyre pozitive sipas nenit 2 (e drejta për jetë), nenit 8 (e drejta për jetën private dhe familjare) dhe nenit 14 (mosdiskriminimi në gëzimin e të drejtave) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) në lidhje me ndryshimet klimatike.^[31] Thelbi i argumentit të aplikantëve është se nenet 2 dhe 8 duhet të lexohen në dritën e instrumenteve të ndryshme ndërkombëtare siç janë Marrëveshja e Parisit dhe Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës. Nëse rasti do të ketë sukses, kjo ka të ngjarë të ketë një efekt domino në politikën e brendshme të shteteve për emetimet e gazrave serrë, e cila pastaj do të ndikojë tek bizneset, veçanërisht në industrinë me emetim të lartë siç janë ndërtimtaria, prodhimtaria dhe prodhimi i energjisë. Derisa një *actio popularis* i tillë është i paprecedentë, ky rast është pjesë e një vale procesesh gjyqësore që përpiqen të sqarojnë lidhjen ndërmjet të drejtave të njeriut dhe ndryshimeve klimatike.^[32]

kundër Italisë (Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998); Rasti *Oneryildiz kundër Turqisë* (Aktgjykimi i 30 nëntorit 2004); Rasti *Fadeyeva kundër Rusisë* (Aktgjykimi i 9 qershorit 2005); Rasti *Tatar kundër Rumanisë* (Aktgjykimi i 27 janarit 2009). Ngjashëm, në rastin *Qendra e Veprimt për të Drejtat Socio-Ekonomike kundër Nigerisë*, Komisioni Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve konstatoi se shteti nigerian e kishte për detyrë të mbronte qytetarët e vet nga shkeljet e të drejtave të tyre nga palët private. Komunikimi 155/96, Komisioni Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve (2001) *Raportet Afrikane të Ligjit për të Drejtat e Njeriut* 60.

- 30 Rasti *Kovacic dhe të tjerët kundër Sllovenisë* (Vendimi mbi pranueshmërinë i 1 prillit 2004).
- 31 Rasti *Duarte Agostinho dhe të tjerët kundër Portugalisë dhe 32 shteteve të tjera* (nr. 39371/20).
- 32 Ngjashëm, një grup grash të moshuara zvicerane në mars 2021 paraqitën një aplikim kundër Zvicrës duke pretenduar se kushtet shëndetësore që i përjetuan si rezultat i valëve të të nxehtit ishin për shkak të dështimit të shtetit për të ndërmarrë hapa për të parandaluar ndryshimet klimatike, duke shkelur kështu nenet 2 dhe 8 të KEDNJ-së. (Rasti *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët kundër Zvicrës* (nr. 53600/20)). Aplikantët po ashtu pretenduan se ishte shkelur neni 6 (e drejta për një gjykim të drejtë –

Në lidhje me shfrytëzimin në punë, GJEDNJ është përgatitur të mbajë shtetet përgjegjëse për shkeljet e ndalesës së punës së detyruar të bëra nga aktorët e sektorit privat. Në rastin e njohur *Chowdury dhe të tjerët kundër Greqisë*, GJEDNJ konstatoi se 42 shtetas të Bangladeshit që punonin në kushte joadekuate dhe shfrytëzuese në një fermë dredhëzash i ishin nënshtruar punës së detyruar dhe trafikimit të qenieve njerëzore dhe se Greqia nuk kishte siguruar mbrojtje efektive, gjë që përbën shkelje të nenit 4 të KEDNJ-së nga Greqia.^[33] Veçanërisht, në një nga rastet më të mëdha të shfrytëzimit të fuqisë punëtore para GJEDNJ-së, që përfshinte rreth 700 punëtorë nga Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe Maqedonia e Veriut, të cilët pretendonin se ishin shfrytëzuar derisa punonin në objektet ndërtimore në Baku (Azerbajxhan), Gjykata e Strasburgut vendosi në favor të aplikantëve.^[34] Gjykata vuri në dukje se Azerbajxhani ishte në dijeni se punëtorët kishin qenë viktimat e mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore dhe të punës së detyruar bazuar në disa raporte të organizatave të shoqërisë civile, si dhe të Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës, por pavarësisht kësaj ai nuk e kishte përmbushur detyrimin e tij procedural për të nisur dhe kryer një hetim efektiv rreth pretendimeve të aplikantëve. Derisa vendimet e GJEDNJ-së janë detyruese vetëm për shtetet, ato ofrojnë një shtysë për veprime rregullative dhe për zbatim më të plotë të standardeve vendore për bizneset dhe aktorët e tjerë privatë.

Ndonëse një analizë më e detajuar e proceseve gjyqësore përkatëse do të jetë pjesë e secilit studim tematik në këtë seri, kjo përmbledhje e shkurtër ilustron një rritje të dukshme të padive (kërkesave) ligjore që kërkojnë të mbajnë përgjegjës si shtetet ashtu edhe kompanitë për

qasje në gjykatë) dhe neni 13 (e drejta për një mjet juridik efektiv). Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian ka zhvilluar seanca dëgjimore edhe për çështje që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike. Në mars 2021, ajo hodhi poshtë një ankesë të dhjetë familjeve që kërkonin të detyronin vetë BE-në të marrë masa më të rrepta për zvogëlimin e emetimeve të gazrat serrë (Rasti *Armando Ferrão Carvalho dhe të tjerët kundër Parlamentit Evropian dhe Këshillit* ('Rasti i Popullit për Klimën') Rasti C-565/19 P).

33 Rasti *Chowdury dhe të tjerët kundër Greqisë*, Aplikimi Nr. 21884/15, 30 mars 2017.

34 Rasti *Seudin Zoletic dhe të tjerët kundër Azerbajxhanit*, Aplikimi Nr. 20116/12, 7 tetor 2021.

shkeljet e standardeve mjedisore dhe të drejtave të njeriut që ndodhin në kontekstin e aktivitetit komercial, në përputhje me aktivitetin e shtuar legjislativ në këtë fushë.

3. Argumentet për respektimin e të drejtave të njeriut

Shtytësit e ndryshimit komercial

Ekzistojnë shtytës pozitivë dhe negativë për firmat në miratimin e një strategjie komerciale të qëndrueshme, të udhëhequr nga të drejtat e njeriut në tërë zinxhirin e vlerës, duke zbatuar kushte të drejta dhe të favorshme të punës, respektim të të drejtave të njeriut dhe praktika të ndërlidhura me ESG-në më gjerësisht. Shtytës të tillë pozitivë dhe negativë të ndryshimit dhe sjelljes së mirë tregtare mund të mendohen edhe si faktorë ‘të bazuar në nxitje’ dhe ‘të bazuar në ndëshkime’ (ose, në një gjuhë më pak formale, si ‘karota’ dhe ‘shkopi’). Masat e aplikuara nga firmat përfshijnë: zbatimin e zellit të duhur (due diligence) për të drejtat e njeriut (HRDD); masat parandaluese, vlerësimet e ndikimit dhe trajnimi në të gjithë zinxhirin e vlerës; dhe sigurimin e pajtueshmërisë rregullative brenda biznesit dhe partnerëve dhe furnitorëve të tyre.

Në thelb, ka gjithnjë e më shumë kuptim biznesor që një biznes të respektojë dhe mbrojë të drejtat e njeriut, të zbatojë qeverisjen e mirë dhe të funksionojë në mënyrë të qëndrueshme. Kompanitë do të humbasin nëse nuk i përmbushin detyrimet e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare, sipas legjislacionit vendor dhe ndaj konsumatorëve, blerësve, furnitorëve, punonjësve, aksionarëve, huadhënësve dhe siguruesve të tyre.

Shtytësit negativë / të bazuar në ndëshkime

Shmangia e rreziqeve ligjore, të reputacionit dhe financiare janë shtytësit kryesorë të përmirësimit të sjelljes komerciale, vendimmarrjes dhe mbikëqyrjes në lidhje me të drejtat e njeriut dhe praktikën e biznesit të bazuar në ESG.

Së pari, siç është shpjeguar në seksionin 2 më lartë, ka pasur një rritje të konsiderueshme të aktivitetit legjislativ në nivel ndërkombëtar, të BE-së dhe të brendshëm [të shteteve] që përpiket të rregullojë aktivitetin komercial në këtë drejtim. Në mënyrë të ngjashme, zotimet ‘vullnetare’ të shteteve, siç janë zotimet ‘Net Zero’ që dalin nga Marrëveshja e Parisit, zakonisht përkthehen në rregullore të detyrueshme për bizneset.^[35] Për më tepër, trendet në proceset gjyqësore civile sugjerojnë se nga kompanitë do të kërkohet tu përmbahen gjithnjë e më shumë standardeve të instrumenteve juridike ndërkombëtare të parapara fillimisht që të jenë detyruese vetëm për shtetet.^[36] Në Evropë, Rregullat e brendshme të vendeve anëtare dhe ato të nivelit të BE-së janë duke pasur gjithnjë e më shumë efekt ekstra-territorial, duke u kërkuar firmave që kanë selitë në BE të planifikojnë respektimin e të drejtave të njeriut edhe nga partnerët dhe furnitorët e tyre jashtë bllokut dhe të kërkojnë që kjo të përmirësohet. Për firmat në Ballkanin Perëndimor që ofrojnë mallra dhe shërbime për konsumatorët e BE-së dhe klientët komercialë, ky është një nxitës gjithnjë e më i rëndësishëm: dështimi për të mbajtur hapin me kërkesat e kornizës rregullative mund t’i ekspozojë firmat ndaj rrezikut për zbatim të detyrueshëm rregullativ, si dhe rrezikut të konkurrencës – duke u përjashtuar nga të qenit furnizues rajonal i zgjedhur i një firme të BE-së në favor të një konkurenti të drejtpërdrejtë.

Një nxitës i dytë i ndryshimit bazuar në ndëshkim është rreziku i reputacionit që lind nga mos pajtueshmëria me rregullat. Pjesa më e madhe e legjislationit vendor që është duke u zhvilluar në Evropë për këtë çështje e pranon rolin e shoqërisë civile në ‘diskreditimin publik’ të firmave që nuk veprojnë në përputhje me këtë, përfshirë nga OJQ-të e të drejtave të njeriut, gazetarët hulumtues dhe organizatat e punëtorëve.^[37]

35 Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, ‘Njoftim për shtyp: Mbretëria e Bashkuar do të bëjë të detyrueshme me ligj raportimet klimatike për kompanitë më të mëdha’ (29 tetor 2021) në dispozicion në <https://www.gov.uk/government/news/uk-to-enshrine-mandatory-climate-disclosures-for-largest-companies-in-law>.

36 Shih veçanërisht rastin holandez *Milieudefensie et al. kundër Royal Dutch Shell* [2021] C/09/571932 / HA ZA 19-379 vendosur në maj 2021.

37 Si Akti Holandez për Zellin e Duhur (due diligence) rreth Punës së Fëmijëve, ashtu edhe

Për shembull, një analizë e hollësishme nga The New York Times^[38] për abuzimet e të drejtave të njeriut tek prodhuesit kinezë furnizues të Apple çuan në thirrje për bojkotim të produkteve të kësaj kompanie në SHBA, duke bërë që Apple të publikonte listën e furnitorëve dhe t'i bashkohej Shoqatës së Punës së Ndershme në 2012.^[39]

Së treti, për firmat e rajonit që kërkojnë të tërheqin investitorë nga një grup global i investitorëve, veprimi në përputhje me të drejtat e njeriut është po ashtu parakusht thelbësor për të marrë fonde. Rritja e Investimit ESG (d.m.th, përfshirë kriteret mjedisore, të qëndrueshmërisë dhe të qeverisjes) gjatë viteve të fundit ka qenë astronomike. Bloomberg parashikon që deri në vitin 2025 asetet ESG nën menaxhim do të jenë një e treta e të gjitha asetëve të zotëruara në nivel global - rreth 50 trilionë dollarë.^[40] Në këtë ambient investues që është duke u zhvilluar, kostot e mundshme për firmat

*Rreziku financiar i ngecjes
prapa: aksionarët marrin masa*

Tre aksionarë aktivistë të rinj u zgjodhën me sukses në bordin e Exxon Mobil në vitin 2021 nga aksionarët me mandat për të ndryshuar rrënjësisht qëllimet e firmës në përputhje me objektivat e ndryshimeve klimatike dhe shqetësimet e tjera të ESG-së.

Akti i Mbretërisë së Bashkuar për Skllavërinë Moderne në MB mbështeten tek shoqëria civile për të sjellë mosrespektimin në vëmendjen e rregullatorëve.

- 38 Charles Duhigg dhe David Barboza, “Në Kinë, kostot njerëzore ndërtohen në një iPad” (New York Times, 25 janar 2012) në dispozicion në: <https://www.nytimes.com/2012/01/26/business/ieconomy-apples-ipad-and-the-human-costs-for-workers-in-china.html>.
- 39 Qendra Burimore për Biznes dhe të Drejta të Njeriut, “Shqetësimet e fundit për zinxhirin e furnizimit të Apple, janar-shkurt 2012” (13 janar 2012) në dispozicion në <https://www.business-humanrights.org/en/latest-news/latest-concerns-re-apple-supply-chain-jan-feb-2012/>.
- 40 “Asetet e ESG-së mund të arrijnë në 53 trilionë dollarë deri në vitin 2025, një e treta e asetëve botërore nën menaxhim” (Bloomberg 23 shkurt 2021) në dispozicion në <https://www.bloomberg.com/professional/blog/esg-assets-may-hit-53-trillion-by-2025-a-third-of-global-aum/>.

që mbeten prapa në respektimin e të drejtave të njeriut mund të jenë të konsiderueshme, sepse investitorët kërkojnë përmirësim të standardeve si kusht për investim. Viteve të fundit po ashtu është vërejtur një rol në rritje i ‘aksionarëve aktivistë’ brenda organizatave. Një shembull i kësaj është kompania amerikane e naftës Exxon Mobil: tre aksionarë të rinj aktivistë u zgjedhën me sukses nga aksionarët që të jenë pjesë e bordit në vitin 2021 me mandat për të ndryshuar rrënjësisht qëllimet e firmës në përputhje me objektivat e ndryshimeve klimatike dhe shqetësimet e përgjithshme të ESG-së.^[41] Vlen të ceket se fushata zgjedhore për bord u zhvillua mbi baza strategjike e jo ideologjike, duke argumentuar se arritjet e kompanisë i kanë zhgënjyer vazhdimisht aksionarët gjatë 10 viteve të fundit dhe se ajo ka nevojë për një drejtim të ri në një botë që po dekarbonizohet me shpejtësi.^[42] Siç shkroi Kryeshefi Ekzekutiv i Blackrock, Larry Fink, në vitin 2020: ‘Dëshmitë mbi rrezikun nga ndryshimet klimatike po i detyron investitorët të rivlerësojnë supozimet themelore rreth financave moderne... Rreziku nga ndryshimet klimatike është rrezik investimi’.^[43] Derisa efektet e ndryshimeve klimatike në biznes po bëhen më të prekshme, rreziku nga ndryshimet klimatike i ka prekur kufijtë, duke ofruar një argument të pastër për veprim të korporatave.

Shtytësit pozitivë / të bazuar në nxitje

Në anën tjetër, ekzistojnë shtytës të rëndësishëm të bazuar në nxitje që i shtynë firmat të ngritin standardet dhe pajtueshmërinë me rregullat, me efekte pozitive në fitim, bazë të konsumatorëve dhe mundësi investimi. Vendosja e respektimit të të drejtave të njeriut në qendër të strategjisë dhe

41 Derek Brower dhe Ortenca Aliaj, “Motori nr. 1, fondi mbrojtës që vret gjigantin” (Financial Times, 3 qershor 2021) në dispozicion në <https://www.ft.com/content/ebfdf67d-cbce-40a5-bb29-d361377dea7a>.

42 Samantha Subramanian, “Fondi i vogël mbrojtës që tronditi ExxonMobil” (Quartz, 28 maj 2021), i disponueshëm në: <https://qz.com/2014413/engine-no-1-the-little-hedge-fund-that-shook-exxonmobil/>.

43 Larry Fink, “Një riformësim themelor i financave” (Blackrock, 16 janar 2020) <https://www.blackrock.com/uk/individual/larry-fink-ceo-letter>.

filozofisë operacionale të një firme paraqet mundësi të rëndësishme për biznesin që të krijojë ose përmirësojë reputacionin si në nivel rajonal ashtu edhe global, për të fituar punë të reja, për të siguruar kredi dhe investime, për të rritur produktivitetin dhe fitimet (veçanërisht në planin afatgjatë) dhe për të tërhequr dhe mbajtur punonjësit e përkushtuar. Për më tepër, kompanitë që tregojnë zellin e duhur (due diligence) për sa u përket zinxhirëve të tyre të furnizimit përfitojnë nga një menaxhim i përmirësuar i rrezikut me më pak gjasa për çrregullim të punës dhe procese gjyqësore, dhe ndryshe nga konkurrentët e tyre, kanë një mundësi më të mëdha për të ruajtur reputacionin e tyre kur ndodhin ndikime negative, duke pasur parasysh se ato, por edhe publiku i kupton më mirë përpjekjet e tyre të përgjithshme për të shmangur incidente të tilla.

Dallohen disa shtytës kyç të bazuar në nxitje. Së pari, lidhja në mes të kushteve të mira të punës, produktivitetit dhe përfitimit ka filluar të bëhet e qartë. Një studim i industrisë së veshmbathjeve në Vietnam nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) arriti në përfundimin se fabrikat në Vietnam që përmirësuan kushtet e tyre të punës për katër vite e rritën raportin e tyre të ardhura - kosto për 25 për qind, fituan deri në 8% më shumë se sa konkurrentët për shkak të rritjes së produktivitetit dhe duke ndërmarrë hapa proaktivë për të fuqizuar mbikëqyrësit e punëtorëve, patën një rritje të produktivitetit prej 22%, normë më të ulët të lëndimeve të punonjësve dhe më pak 'ikje' të punonjësve.^[44] Prandaj, kompanitë që

Kushtet më të mira të punës rrisin rezultatin përfundimtar të fabrikës:

Sipas një studimi fabrikat në Vietnam që përmirësuan kushtet e tyre të punës rritën raportin e të ardhurave ndaj koston për 25%, kishin deri në 8% më shumë fitim se konkurrentët dhe kishin një rritje të produktivitetit prej 22%.

44 Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) dhe Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC), 'Progresi dhe potenciali: Si është duke e përmirësuar programi Puna më e Mirë (Better Work) jetën e punëtorëve të veshmbathjeve dhe duke rritur aftësinë konkurruese të fabrikës. Përmbledhje e një vlerësimi të pavarur të programit Puna më e Mirë' (Better Work) (2016).

mbështesin kushte të drejta dhe të favorshme të punës mund të presin marrëdhënie më të mira me punëtorët, komunitetet dhe palët e tjera të interesit në shoqëri, duke rezultuar kështu në besim më të madh dhe në një licencë më të fuqishme shoqërore për të punuar.

Së dyti, lidhja në mes të standardeve të shëndosha të qëndrueshmërisë dhe kostos së performancës së kapitalit, operacionale dhe çmimit të aksioneve tashmë është e vendosur mirë. Një meta-studim i mbi 200 studimeve akademike dhe raporteve të industrisë i bërë nga Universiteti i Oksfordit erdhi

ESG përmirëson performancën e aksioneve:

Një studim i bërë nga Universiteti i Oksfordit gjeti se praktikatat tregtare që janë në përputhje me kriteret ESG rezultojnë në performancë më të mirë operacionale.

në përfundimin se praktikatat tregtare që ishin në përputhje me kriteret ESG rezultojnë në performancë më të mirë operacionale për firmat dhe se praktikatat e mira të qëndrueshmërisë mund të ndikojnë pozitivisht në performancën e çmimeve të aksioneve të kompanive.^[45] Përveç kësaj, rritja e reputacionit të firmave u siguron atyre qasje më të mirë në mundësitë për të punuar me qeveritë, investitorët dhe blerësit, të cilët gjithnjë e më shumë e kuptojnë se është më pak rrezik për to kur punojnë me një kompani që menaxhon në mënyrë efektive rreziqet për të drejtat e njeriut.

Së treti, dinamika në mesin e firmave për nxitjen e respektimit të të drejtave të njeriut dhe praktikave të qëndrueshme tregtare tani po nxit një trend të rëndësishëm komercial në të gjithë tregun, ku ‘interesi më i madh vetjak’ tani udhëheq filozofinë për praktikën tregtare. Një gamë e gjerë [korporatash] shumëkombëshe dhe investitorësh kanë dalë me deklarata publike dhe aprovime në mbështetje të HRDD-së së detyrueshme si pjesë e një trendi më të gjerë drejt praktikave tregtare që i respektojnë të drejtat

45 Gordon Clark, Andreas Feiner, Michael Viehs, ‘Nga aksionari te pala e interesit: Si mund të nxisë qëndrueshmëria rritjen e performancës financiare’ (22 tetor 2014) në dispozicion në SSRN: <https://ssrn.com/abstract=2508281>.

e njeriut, duke përfshirë shumë firma që blejnë nga furnitorët në rajonin e Ballkanit Perëndimor.^[46]

Një shembull i kësaj është Waitrose, një zinxhir i madh supermarketesh britanike, i cili ka marrë lëvdata për qëndrueshmërinë e fortë të tij, për kriteret ESG dhe politikat e të drejtave të njeriut dhe i cili blen produkte nga furnitorët në Maqedoninë e Veriut.^[47] Kompania Unilever paraqet një shembull në shkallë globale. Ajo është në krye të Indeksit të Qëndrueshmërisë së OKB-së nga viti 2015 dhe ende mund të mburret me rritjen e fitimeve dhe vlerën e aksioneve. Në vitin 2019, ajo njoftoi se brendet e saj që ndërmorën veprime për njerëzit dhe planetin u rritën për 69% më shpejt se pjesa tjetër e biznesit të saj dhe përfaqësonin 75% të rritjes së përgjithshme të saj.^[48] Në vitin 2018, Unilever bashkëpunoi me UN Women dhe 22 kompani të tjera në një “Koalicion Global të Inovacionit për Ndryshim”, duke bërë një zotim global që gjysma e të gjitha bizneseve fillestare me të cilat do hyjnë në partneritetet deri në vitin 2023 do të jenë të themeluara nga femrat, duke e quajtur zotimin e saj ndaj diversitetit gjinor si “kritik për biznesin”.^[49]

Prandaj, këto biznese ‘të përndritura’, si Unilever dhe Waitrose, po e kuptojnë drejtimin e udhëtimit dhe po e shfrytëzojnë atë duke qenë ‘të

46 Qendra Burimore për Biznes dhe të Drejta të Njeriut, “Lista e bizneseve të mëdha, shoqatave dhe investitorëve që kanë bërë deklarata publike dhe aprovime në mbështetje të rregullimit të detyrueshëm të zellit të duhur” (6 qershor 2019) në dispozicion në <https://www.business-humanrights.org/en/latest-news/list-of-large-businesses-associations-investors-with-public-statements-in-dorsements-in-support-of-mandatory-due-diligence-rregullore/>.

47 Shih <https://pelagonia.co.uk/where-to-buy/>.

48 Unilever, “Rriten brendet me qëllime të qarta - dhe ja prova” (11 qershor 2019) në dispozicion në <https://www.unilever.com/news/news-and-features/Feature-article/2019/brands-with-purpose-grow-and-here-is-the-proof.html>.

49 Unilever Foundry, Rritja e diversitetit: Unilever Foundry zotohet për barazi gjinore (2018) në dispozicion në <https://www.theunileverfoundry.com/highlights/gender-equality-at-startups-case-study.html>.

parët që lëvizin' në këtë drejtim. Përfitimet e mundshme nga të qenit të parët në lakoren e zhvillimit janë të qarta. Megjithatë, për bizneset më pak të guximshme ose më pak inovative, ndryshimi i rrethanave është hutues: derisa obligimet e biznesit, të drejtave të njeriut dhe mjedisit po ndryshojnë gradualisht dhe pak nga pak nga të qenit vullnetare në të detyrueshme. Kur shitësi online i veshjeve me pakicë në Mbretërinë e Bashkuar, Boohoo, iu nënshtrua një shqyrtimi fajësues të zinxhirit të tij të furnizimit në vitin 2020, ai u përgjigj me vendosmëri duke ndërprerë nënkontraktimin dhe duke konsoliduar rrjetin e tij të furnizuesve nga pothuaj 500 në 78. Përkundër kësaj, Tesco, John Lewis, Primark, Asos dhe Co-op i bënë thirrje qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të aplikojë legjislacionin e detyrueshëm për zellin e duhur (due diligence), i cili do ta konsideronte Boohoo ligjërisht përgjegjëse. Në fund të fundit, bizneset dëshirojnë siguri, e cila mundësohet nga një ambient i qartë rregullativ. Në një studim të kohëve të fundit lidhur me projektligjin e BE-së për zellin e duhur, pothuajse të gjithë të intervistuarit ishin në parim në favor të një mundësie politike për të aplikuar një detyrim të përgjithshëm për zellin e duhur në nivel të BE-së në mënyrë që të krijohen kushte të barabarta për të gjithë.^[50] Kjo i shmang grackat e bizneseve që përpiqen të 'bëjnë gjënë e duhur' duke marrë përsipër publikisht detyrime vullnetare dhe duke u mbajtur përgjegjëse për mospërbushjen e tyre.

*'Vetë-interes i përndritur'
- kompanitë që përfitojnë
nga trendet globale*

Unilever ka kryesuar Indeksën e Qëndrueshmërisë së OKB-së nga viti 2015 dhe ende mund të mburret me rritjen e fitimeve dhe vlerën e aksioneve. Brendet e saj që ndërmarrin veprime për njerëzit dhe planetin u rritën për 69% më shpejt se pjesa tjetër e biznesit të saj dhe përfaqësonin 75% të rritjes së përgjithshme të saj në 2019

50 Lise Smit et al., Studim mbi kërkesat për zellin e duhur (due diligence) përmes zinxhirit të furnizimit: Raporti përfundimtar' (Komisioni Evropian, 2020).

Shërbimet financiare

Investitorët në tërë botën po kërkojnë gjithnjë e më shumë që firmat të përmirësojnë standardet e respektimit të të drejtave të njeriut, zellin e duhur (due diligence) dhe matjen dhe raportimin e qëndrueshmërisë si parakushte për investime të vazhdueshme, së bashku me një qëndrim të ‘pronësisë aktive’ që promovon një qasje të politikës së ‘administrimit’. Ky trend po vihet në lëvizje si nga trendi kryesor i tregut në këtë drejtim ashtu edhe nga hapat e vegjël të rregullimit të investitorëve që po zhvendoset gjithnjë e më shumë nga të qenit vullnetar në atë të detyrueshëm.

Për sa i përket perspektivës së shërbimeve financiare, nga rritja masive e investimeve ESG vërehet qartë se investitorët po i marrin seriozisht çështjet e ESG-së dhe po paraqesin kërkesa të shumta për firmat në të cilat investojnë ose japin kredi, me rrezikun e humbjes së investimeve. Megjithatë, vlen po ashtu të theksohet se kjo zhvendosje drejt investimeve të qëndrueshme ka kuptim në aspektin financiar. Gjatë tronditjes së stuhishme ekonomike të shkaktuar nga Covid-19, investimet e ESG janë zhvilluar veçanërisht mirë. Hulumtimi i Bloomberg-ut konstatoi se në tremujorin e parë të vitit 2020, produktet e investimeve të qëndrueshme performuan më mirë se produktet jo-ESG, ku 94% e përzgjedhjes përfaqësuese globale të indekseve të qëndrueshme të analizuarra gjerësisht tejkalonin standardet e tyre amë.^[51] Gjatë pandemisë, investitorët kanë vazhduar të preferojnë asetet e qëndrueshme, ku fondet e hapura të qëndrueshme globale kanë pasur një rritje prej 41% nga viti në vit në TMI 2020. Këto trende përmbysin thënien e cituar shpesh në periudhën para krizës së Covid-it se gjatë krizave të mëdha të tregut investitorët nuk do të kenë prioritet qëndrueshmërinë dhe do të ikin drejt investimeve të sigurta. Megjithatë, të dhënat tregojnë se investimi ESG është padyshim e ardhmja e praktikës së investimit, si në kohë të mira ashtu edhe në të këqija.^[52] Është e qartë se investimet e tilla konsiderohen të jenë mjaft të qëndrueshme për t'i bërë ballë një periudhe të pasigurisë së madhe ekonomike siç është

51 Blackrock, “Investimi i qëndrueshëm: rezistencë në mes të pasigurisë” (Mars 2020).

52 Larry Fink, “Një riformësim themelor i financave” (Blackrock, 16 janar 2020) <https://www.blackrock.com/uk/individual/larry-fink-ceo-letter>.

pandemia Covid-19, duke forcuar aspektet themelore të funksionimit të zinxhirit të furnizimit, duke faktorizuar dhe zbutur ekspozimin ndaj rrezikut nga ndryshimet klimatike dhe duke promovuar një tipar të qëndrueshëm dhe produktiv të biznesit që favorizon perspektivën e rritjes afatgjatë.

Gjithnjë e më shumë, investimi ESG është bërë edhe ligj. Për sa i përket kuadrit rregullativ që nxit investimet ESG, rregullorja më e njohur që është duke u zhvilluar aktualisht është Rregullorja e BE-së për Raportimin e Qëndrueshëm Financiar (SFDR), e cila hyri në fuqi në vitin 2021 si pjesë e Planit të Veprimit të BE-së për Financa të Qëndrueshme, një paketë kjo

e Masave të BE-së që nxisin praktikën e qëndrueshme financiare dhe kërkesat për raportim.^[53] SFDR-ja synon të krijojë kushte të barabarta për transparencën dhe sigurimin e informacioneve në lidhje me rreziqet e qëndrueshmërisë/ESG-së, duke kërkuar që këshilltarët financiarë, menaxherët e aseteve, bankat dhe pjesëmarrësit e tjerë në treg të vënë në dispozicion informacionet përkatëse në lidhje me ESG-në për firmat. Kjo do të thotë që firmat që marrin investime nga pjesëmarrësit në treg që gjenden në BE do të detyrohen që të bëjnë raportime gjithnjë e më të hollësishme lidhur me rreziqet dhe politikën e tyre të qëndrueshmërisë si pjesë e zellit të duhur (due diligence) të investitorëve para blerjes, ose si kërkesë për investim të vazhdueshëm. Zhvillime të ngjashme mund të shihen edhe në komunitetet investuese të Amerikës së Veriut dhe Azisë, të shtyrë nga trendet dhe kornizat globale.

Rregullorja e BE-së për Raportimin e Financave të Qëndrueshme (SFDR):

Firmave që marrin investime nga pjesëmarrësit e tregut që gjenden në BE do t'u kërkohej të bëjnë raportime gjithnjë e më të detajuara në lidhje me rreziqet dhe politikën e tyre të qëndrueshmërisë, si kërkesë për vazhdim të investimeve.

53 Vini re se SFDR nuk është ende plotësisht në funksion. Masat e tjera të aplikuara si pjesë e Planit të Veprimit të Komisionit Evropian për Financa të Qëndrueshme përfshijnë Rregulloren e Taksonomisë, e cila paraqet një skemë klasifikimi në tërë BE-në për aktivitetet e qëndrueshme, dhe Rregulloren mbi Standardet e Emetimit të Ulët të Karbonit.

SFDR-ja bazohet edhe në Direktivën e BE-së për Raportimin Jofinanciar 2014 (ang. NFRD) 2014, e cila kërkon që disa kompani të mëdha të caktuara të zbulojnë informacione mbi mënyrën se si ato operojnë dhe menaxhojnë sfidat sociale dhe mjedisore. Këtyre kompanive u kërkohet të publikojnë informacion mbi çështjet mjedisore; çështjet sociale dhe trajtimin e punëtorëve; respektimin e të drejtave të njeriut; luftimin e korrupsionit dhe ryshfetit; dhe diversitetin në bordet e kompanive. Për më tepër, NFRD-ja përfshin një mekanizëm të “respektimit dhe shpjegimit” përmes të cilit kompanitë mund të vendosin të mos i raportojnë [ato informacione] duke shpjeguar pse nuk i raportojnë: ndonëse ky mekanizëm në dukje ofron një mënyrë për të shmangur zbulimin [e informacioneve], firmat që aplikojnë një qasje minimale dhe të mbyllur ndaj zbulimit të informacioneve ka të ngjarë të kuptojnë se klientët dhe investitorët e tyre me siguri do të analizojnë në detaje arsyet e paraqitura për mospërputhshmëri si pjesë e zellit të tyre të duhur (due diligence) dhe të kërkojnë të bëhen përmirësime nëse konstatohen se janë të nevojshme. Që nga viti 2014, Komisioni Evropian ka publikuar udhëzues të tjerë për raportimin rreth klimës në 2017 dhe 2019 që ofrojnë udhëzime për kompanitë se si të raportojnë mbi ndikimet e biznesit të tyre në klimë dhe mbi ndikimet e ndryshimeve klimatike në biznesin e tyre.^[54]

Krahas rregullave të detyrueshme, ka një mori standardesh të tjera më vullnetare që janë zhvilluar si praktika më e mirë për menaxhimin e investimeve. Këtu hyjnë Parimet për Investim të Përgjegjshëm (PRI), një grupim vullnetar i parimeve të investimit që tregojnë qasje për përfshirjen e çështjeve të ESG-së në praktikën e investimeve, siç janë ndjekja e politikave aktive të pronësisë dhe kërkimi i zbulimit të duhur të informacioneve për ESG-të nga firmat që marrin investime. Rreth 4,000 menaxherë të investimeve dhe investitorë në mbarë botën janë regjistruar në PRI që nga fillimi i zbatimit të tyre në vitin 2004. Ndonëse është sistem vullnetar, ai është bërë një kornizë mjaft e konsoliduar e investimit të përgjegjshëm për të vepruar si masë mbrojtëse për menaxherët e aseteve që bëjnë verifikimin

54 Komisioni Evropian, ‘Udhëzimet për raportimin jofinanciar: Plotësim mbi raportimin e informacionit lidhur me klimën’ (2019/C 209/01), OJ C 209, 20 qershor 2019.

e bizneseve për ESG, dhe rrjedhimisht është duke ngritur standardet për investitorët të cilat më pas barten tek firmat për sa i përket kërkesave të investitorëve për performancën e investimit.

PRI sugjeron që çështjet ESG mund të përfshihen në praktikat ekzistuese të investimit duke përdorur një kombinim me tri qasje: integrimi – duke përfshirë në mënyrë eksplicite çështjet ESG në analizën e rrezikut të investimeve dhe në vendimmarrje; verifikimi – aplikimi i filtrave për investimet potenciale bazuar në preferenca, vlera ose etikë; dhe qasjet tematike – duke kërkuar të kombinohen profile atraktive të kthimit të rrezikut me synimin për të kontribuar në një rezultat specifik mjedisor ose social. Për më tepër, PRI-të konsiderojnë se performanca ESG e portofoleve ekzistuese të investimit mund të përmirësohet përmes praktikave aktive të pronësisë siç është angazhimi - diskutimi i çështjeve ESG me kompanitë për të përmirësuar trajtimin e tyre, përfshirë bërjen publike të çështjeve të tilla; dhe me anë të votimit të autorizuar - duke shprehur zyrtarisht miratimin ose mosmiratimin përmes votimit për rezolutat dhe propozimin e rezolutave të aksionarëve për çështje specifike të ESG-së.

PRI është vetëm njëra nga një numër i kornizave me ndikim që udhëheqin gjithnjë e më shumë praktikën e investitorëve në këtë fushë. Një kornizë tjetër kyçe është Udhëzuesi i Task Forcës për Raportime Financiare Lidhur me Klimën (ang. TCFD), të cilat janë të fokusuara në rreziqet mjedisore, por kanë pasur një ndikim të madh edhe në industrinë e financave në tërësi dhe janë integruar në PRI dhe gjithnjë e më shumë në rregullat e raportimit të BE-së. Udhëzimet e TCFD-së janë dizajnuar për të promovuar raportimet financiare që kanë të bëjnë me klimën, duke u mundësuar palëve të interesuara të kuptojnë më mirë ekspozimin financiar ndaj rreziqeve që lidhen me klimën, dhe janë miratuar nga një gamë e konsiderueshme e fondeve pensionale, bankave dhe kompanive të sigurimit në mbarë botën, të cilat po kërkojnë që të paraqiten gjithnjë e më shumë informacione mjedisore nga firmat që marrin financim. Mbretëria e Bashkuar po ashtu është zotuar ta bëjë të detyrueshme paraqitjen e informacioneve shpjeguese në përputhje me TCFD-në në të gjithë ekonominë deri në

vitin 2025.^[55] Mbretëria e Bashkuar dhe Japonia po ashtu kanë një ‘Kod administrimi’, i cili vendos standarde të larta për menaxherët e investimeve dhe përfshin një sërë parimesh ‘apliko dhe shpjego’ për demonstrimin e praktikave më të mira në investimet e qëndrueshme.^[56]

Derisa kornizat rreth investimeve ESG po zhvillohen dhe zbatohen në shumë fusha, në praktikë po shfaqen trende të reja. Një prej tyre është parimi “Mos bëj dëm të madh”, sipas të cilit një firmë që ndjek *në mënyrë aktive* objektivat e qëndrueshëm (p.sh. zbutjen/përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike) nuk mund të kualifikohet si e qëndrueshme sipas kriterëve përkatëse nëse shkakton dëm të konsiderueshëm ndaj një objekti tjetër të qëndrueshëm. Për shembull, nëse një fabrikë në Ballkanin Perëndimor që prodhon panele diellore fotovoltaike – që sigurisht konsiderohet si veprimtari e qëndrueshme biznesi – konstatohet se është duke shkelur kushtet e shëndetit dhe sigurisë [në punë], duke ndotur mjedisin përreth ose duke siguruar lëndë të parë për të prodhuar pila nga burime jo të qëndrueshme (p.sh., përmes përdorimit të fuqisë punëtore të trafikuar ose fëmijët në një vend tjetër), mund të mos i përmbush kërkesat ESG të investitorëve për vazhdim të investimit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në nxitimin drejt një ekonomie me emetim të ulët të karbonit: në një standard të kohëve të fundit të të drejtave të njeriut të kompanive më të mëdha të energjisë së ripërtërishme, është konstatuar se asnjë nga kompanitë e analizuar nuk i përmbushte plotësisht përgjegjësitë e saj për të mbrojtur të drejtat e njeriut siç përcaktohet nga UNGP-të. Kompanitë të cilat mund të përmbushin objektivat sociale dhe mjedisore, duke marrë parasysh të drejtat e njeriut dhe çështjet mjedisore bashkërisht dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse, do të kenë përparësi të qartë konkurruese kur bëhet fjalë për tërheqjen e investimeve.^[57]

-
- 55 Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, Rregullatori i përbashkët i Mbretërisë së Bashkuar dhe Task Forca TCFD e qeverisë: Raporti i përkohshëm dhe udhërrëfyesi’ (9 nëntor 2020).
- 56 Kodi i Administrimit i Mbretërisë së Bashkuar 2020; Agjencia Japoneze e Shërbimeve Financiare, Finalizimi i Kodit të Administrimit të Japonisë (Botimi i dytë i rishikuar).
- 57 Qendra Burimore e Biznesit dhe të Drejtave të Njeriut, ‘Energjia e Ripërtërishme dhe Standardi i të Drejtave të Njeriut’ (29 qershor 2020) në dispozicion në <https://www.>

Listat e përjashtimeve

Më tej, fakti që disa nga kornizat e cituara më lartë janë vullnetare nuk do të thotë se ato thjesht mund të shpërfillen. Investitorët po mbajnë një qëndrim gjithnjë e më të ashpër ndaj mosrespektimit nga firmat që marrin investime, përfshirë përmes menaxhimit aktiv, votimit kundër vendimeve të bordit, madje edhe me tërheqjen nga investimi. Listat e përjashtimeve të investorëve tani publikohen, duke u shkaktuar probleme potencialisht të mëdha të reputacionit për firmat. Një hulumtim i botuar në Gazetën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe i bazuar në intervistat me drejtuesit e bizneseve vuri në dukje se gjithnjë e më shumë institucionet financiare po i shikojnë të drejtat e njeriut me të njëjtat thjerrëza sikurse rrezikun e krimit financiar kur i pranojnë klientët.^[58]

Për shembull, kompania holandez e sigurimeve dhe menaxheri i aseteve Aegon tani i përjashton firmat nga investimi i mundshëm në bazë të kategorive përjashtuese ku përfshihen ndryshimet klimatike, biodiversiteti dhe shëndeti/mirëqenia, si dhe angazhimi i pamjaftueshëm i firmës pas mospërputhjes me standardet globale. Lista e Aegonit 2021 përjashton firma të ndryshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë Badeco-Adria d.d. (BiH - duhan), Čoka Duvanska Industrija A.D. (Serbi - duhan), Holding Korporacija Krusik AD Valjevo (Serbia - armë), ITC d.o.o. (BiH - kimikate), Stari Graničar d.o.o. (Kroaci - armë), dhe Tutunski Kombinat A.D. Prilep (Maqedoni e Veriut - duhan).^[59]

business-humanrights.org/en/from-us/briefings/renewable-energy-human-rights-benchmark/

- 58 Lise Smit et al. "Zelli i duhur për të drejtat e njeriut në zinxhirët global të furnizimit: dëshmi nga praktikat e korporatave për të informuar standardin ligjor" (2021) 25 (6) Gazeta Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut 945-973, 966.
- 59 Aegon Nederland NV, 'Lista e Përjashtimeve nga Investimet e Përgjegjshme' (1 janar 2021).

Qasja e Aegon po bëhet gjithnjë e më e përhapur në industri: Lista e përjashtimeve të bankës daneze Nordea citon një varg arsyesh për përjashtim, përfshirë shkeljen e normave që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut,^[60] ndërsa dega e administrimit të aseteve të kompanisë holandeze të sigurimeve NN Group, NN Investment Partners, përjashton në mënyrë specifike firmat në bazë

Listat e përjashtimeve: Aegon

Kompania holandeze e sigurimeve dhe menaxhuesi i aseteve Aegon tani i përjashton firmat nga investimet e mundshme në bazë të kategorive përjashtuese.

Lista e Aegon 2021 përjashton firma të ndryshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

të ‘shkeljeve të standardeve ndërkombëtare të sjelljes së biznesit’.^[61] Së fundmi, një numër fondesh pensionale holandeze kanë tërhequr investimet nga disa kompani kineze pasi u bënë publike detaje mbi përfshirjen e tyre në shtypjen e ujgurëve në provincën Xinjiang të Kinës.^[62] Është e qartë se mospërbushja e detyrimeve për të drejtat e njeriut dhe praktikat më të mira që po krijohen për zellin e duhur (due diligence) në zinxhirin e furnizimit mund të kenë ndikime të prekshme në aftësinë e firmave për të tërhequr dhe mbajtur investime.

60 Nordea, ‘Lista e Përjashtimeve’ (Tetor 2021) në dispozicion në: <https://www.nordea.com/en/sustainability/exclusion>.

61 NN Investment Partners, ‘Lista e Përjashtimeve të NN Group (2 nëntor 2021) në dispozicion në <https://bit.ly/35PuNv6>.

62 Frank Van Alphen, “Fondet pensionale holandeze largohen nga kompanitë kineze për shkak të shqetësimeve lidhur me ujgurët” (21 maj 2021) në dispozicion në <https://www.ipe.com/news/dutch-pension-funds-exit-chinese-companies-over-uyghur-concerns/10052947.article>.

4. Konteksti rajonal: Biznesi, të drejtat e njeriut dhe mjedisi në Ballkanin Perëndimor

Shumë çështje urgjente në rajon, si diskriminimi në punë dhe mbrojtja e pamjaftueshme e sinjalizuesve,^[63] zbatimi joadekuat i standardeve të shëndetit dhe sigurisë [në punë],^[64] puna joformale e përhapur^[65] dhe praktikatat e tjera që mund të çojnë në shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, kanë një dimension të biznesit dhe të drejtave të njeriut. Prandaj, ekziston një nevojë urgjente për të analizuar se si standardet përkatëse të vendosura nga instrumentet që u diskutuan më lartë mund të vihen në funksion në juridiksionet e Ballkanit Perëndimor në mënyrë që të zhvillohet një qasje gjithëpërfshirëse dhe proaktive ndaj biznesit dhe të drejtave të njeriut.

Deri më sot, kompanitë në rajon e kanë menaxhuar ndikimin e tyre në të drejtat e njeriut kryesisht përmes kornizave të përgjegjësisë shoqërore të korporatave (CSR), duke u fokusuar në veprimet vullnetare që kontribuojnë në planin e tyre të biznesit.^[66] Ndonëse këto praktika janë të

- 63 Komisioni Evropian, Komunikimi mbi politikën e zgjerimit të BE-së COM (2020) 660 final (6 tetor 2020); S. Bradaš, M. Reljanović, I. Sekulović, 'Uticaj epidemije COVID-19 na položaj i prava radnica i radnika u Srbiji' (Fondacija Centar za demokratiju i Kancelarija za ljudska prava Ujedinjenih nacija, 2020) 46; M. Reljanović, 'Studim mbi zbatimin e ligjit kundër diskriminimit në Serbi' (Yucom 2018) 16; A. Papa, Z. Kongoli, 'Standardet e Punës në Shqipëri' (2016).
- 64 Balcanosh, 'Siguria dhe shëndeti në punë – Studim i Malit të Zi' (16 nëntor 2018); Komisioni Evropian, Komunikimi mbi politikën e zgjerimit të BE-së COM(2020) 660 final (6 tetor 2020), Komisioni Evropian, 'Raporti për Serbinë 2020', SWD(2020) 352 final (6 tetor 2020) 95; Petar Bulat, Kenichi Hirose, Jovan Protic, 'Siguria dhe shëndeti në punë në sektorin e ndërtimitarisë në Serbi' (ILO 2018).
- 65 Banka Botërore, 'Trendet e tregut të punës në Ballkanin Perëndimor: 2019 '(19 Mars 2019); Unija Podslodovaca Crne Gore (Unioni i Punëdhënësve të Malit të Zi), "Ekonomia Joformale në Mal të Zi" (2020).
- 66 Jernej Letnar Čerňič, 'Identifikimi i bizneseve dhe të drejtave të njeriut në Evropën Qendrore dhe Lindore' (Cambridge Core Blog, 2021)

rekomandueshme, zhvillimet në agjendën e BHRE-së të përshkuara më lart tregojnë se iniciativat e CSR-së më nuk mund të jenë zëvendësim për përgjegjësinë e korporatave për respektimin e të drejtave të njeriut dhe standardeve mjedisore.

Përveç kësaj, zhvillimet paralele rregullative dhe investuese në Ballkanin Perëndimor e rrisin nevojën për të përfshirë agjendën e BHRE-së e cila po evoluon me shpejtësi. Kështu, juridiksionet e Ballkanit Perëndimor po përballen me një presion të vazhdueshëm për të vazhduar harmonizimin e legjislacionit të tyre përkatës me *acquis* e BE-së, përfshirë edhe atë në lidhje me biznesin dhe të drejtat e njeriut. Një shembull i këtij trendi janë politikat e BE-së dhe vendeve që janë duke u zhvilluar në fushën e zhvillimit të gjelbër dhe ndryshimeve klimatike, përfshirë Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor dhe Mekanizmin për përshtatjen e kufirit të emetimit të karbonit, të cilat do të kenë një ndikim të konsiderueshëm në bizneset në rajon.^[67]

Për më tepër, duke pasur parasysh nivelet e larta të papunësisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor – më i larti në Evropë^[68] – tërheqja e investimeve të huaja është bërë prioritet si çështje e politikës shtetërore, për shkak të kontributit të saj në zhvillimin rajonal. Derisa Ballkani Perëndimor po bëhet gradualisht një vend alternativ për firmat që të vendosin operacionet e tyre tregtare, ekziston një numër proporcionalisht më i madh i investimeve të huaja direkte për të cilat shtetet dhe firmat e rajonit duhet të konkurrojnë.^[69] Por tërheqja e investimeve gjithnjë e më shumë shkon krahas respektimit të provueshëm të të drejtave të njeriut dhe standardeve mjedisore. Kështu, firmat e rajonit do të përfitojnë nga përfshirja e agjendës së biznesit dhe

67 Shih Deklaratën e Sofjes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor (10 nëntor 2020); Komisioni Evropian, Mekanizmi për përshtatjen e kufirit të emetimit të karbonit (14 korrik 2021).

68 Banka Botërore, Raporti i Rregullt Ekonomik për Ballkanin Perëndimor, Nr. 19, Pranverë 2021 Rimëkëmbje e vështirë.

69 Zoran Nechev, Marie Jelenka Kirchner, 'Koha për të lëvizur në Ballkanin Perëndimor: Si mund të ndihmojë diversifikimi i zinxhirëve global të furnizimit në qëndrueshmërinë e BE-së' Dokument i politikës Nr.9/2021 (Prill 2021).

të drejtave të njeriut në planifikimin e tyre komercial me qëllim që të vazhdojnë tërheqjen e investimeve të huaja – që mbetet prioritet kryesor për qeveritë e rajonit.^[70]

Përveç tërheqjes së investimeve, korporatat janë të interesuara në përmirësimin e performancës së tyre lidhur me të drejtat e njeriut për arsye të reputacionit. Ka prova të shumta se politika e qeverive në rajon është duke u dhënë prioritet investimeve më shumë se të drejtave të njeriut dhe standardeve mjedisore, gjë që ka çuar në skandale dhe sfida publike që kanë pasur si bazë mjedisin dhe të drejtat e njeriut, siç është rasti me fabrikën Yura në Serbi;^[71] digat e hidrocentraleve në lumin Kruščica në Bosnje dhe Hercegovinë; diga Buk Bijela në lumin Drina^[72] në Bosnje dhe Hercegovinë; shkelja e të drejtave të njeriut nga Teleperformanca në Shqipëri;^[73] puna joformale dhe e fëmijëve në industrinë e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë;^[74] dhe fabrika Geox në Maqedoninë e Veriut, e

-
- 70 Darko Marjanovic, Mihajlo Djukic, ‘Vendet e Ballkanit Perëndimor si një destinacion tërheqës për investime’, (2020) 53 (2) Analizë ekonomike: Hulumtim i aplikuar në tregjet në zhvillim.
- 71 Qendra Burimore për Biznes dhe të Drejta të Njeriut, ‘Serbia: Punëtorët e fabrikës YURA Corp ankohen për abuzime të pretenduara përfshirë rrahje, ngacmime seksuale, mosdhënie të pagave dhe mohim të lirisë së tubimit, (4 korrik 2016) në dispozicion në <https://www.business-humanrights.org/en/latest-news/serbia-yura-corps-factory-workers-complain-about-alleged-abuse-including-beatings-sexual-harassment-non-payment-of-paga-mohimi-i-lirise-e-shoqerimit/>.
- 72 Pippa Gallop, ‘Vënia e ‘gurthemelit’ të digës mbi Drinë shoqërohet me skepticizëm dhe protesta’ (BankWatch Network, 17 maj 2021) në dispozicion në <https://bankwatch.org/blog/drina-dam-groundbreaking-event-met-by-septicism-and-protests>.
- 73 ‘Personi kontaktues francez i OECD-së i bën thirrje Teleperformancës që të shtojë përpjekjet për të garantuar respektimin e të drejtave të njeriut dhe sigurinë e punëtorëve’ (Uni Global Union, 2 gusht 2021) në dispozicion në <https://uniglobalunion.org/news/french-oecd-contact-point-calls-teleperformance-strengthen-efforts-ensure-respect-human-rights>.
- 74 Stuart Greer, ‘Nevoja e madhe për të mbijetuar’ i shtyn romët e Kosovës drejt riciklimit të rrezikshëm’ (RFERL, 9 tetor 2019) në dispozicion në <https://www.rferl.org/a/a/a-dire-need-to-survive-drives-kosovo-roma-to-risky-recycling/30207749.html>.

cila akuzohet për kushte të këqija dhe shfrytëzuese të punës.^[75] Në tetor 2019, Banka Evropiane e Investimeve konfirmoi se kishte vendosur të mos vazhdonte me financimin direkt për një furrë për djegien e mbeturinave komunale (incinerator) me kapacitet prej 340,000 tonësh në vit në Vinča të Serbisë, pasi vetë zelli i saj i duhur (due diligence) kishte konfirmuar se projekti kishte mundësi të ndërhynte në mundësinë e Serbisë për të përmbushur objektivat e ekonomisë qarkore të BE-së për riciklimin.^[76]

Në fund, kundërthënia e kohëve të fundit që ka dal nga prania e kompanisë minerare Rio Tinto në Serbi shërben si një përkujtues i zymtë se vëmendja e pamjaftueshme ndaj implikimeve të mundshme në të drejtat e njeriut dhe në mjedis të përpjekjeve të bizneseve mund të rezultojnë në trazira shoqërore, duke dëmtuar stabilitetin politik dhe sigurinë në rajon.

Pavarësisht nga këto shembuj negativë, është e rëndësishme të theksohet se disa investitorë të mëdhenj në rajon, përfshirë kompanitë Telenor,^[77]

-
- 75 Qendra Burimore për Biznes dhe të Drejta të Njeriut, 'Raportet flasin për kushte të këqija të punës në zinxhirët e furnizimit të këpucëve në Evropën Lindore; janë përfshirë edhe përgjigjet e kompanisë' (2016) në dispozicion në <https://www.business-humanrights.org/en/latest-news/reports-allege-poor-working-conditions-in-shoe-supply-chains-in-eastern-europe-company-responses-included/>.
- 76 Qendra Burimore për Biznes dhe të Drejta të Njeriut, "Një e treta e huave të Bankës Evropiane të Investimeve nuk i respektojnë rregullat mjedisore dhe sociale" (2021) në dispozicion në <https://www.business-humanrights.org/en/latest-news/a-third-of-european-investment-bank-lending-evades-environmental-and-social-rules-report-alleges/>.
- 77 Telenor Group, 'Menaxhimi i të Drejtave të Njeriut', në dispozicion në <https://www.telenor.com/sustainability/responsible-business/human-rights/mitigate/>.

Coca Cola,^[78] Delhaize,^[79] Topi,^[80] Henkel,^[81] dhe Michelin^[82] duket se i pranojnë praktikat më të mira të standardeve të të drejtave të njeriut në politikat e tyre, duke vënë theksin te UNGP-të dhe përdorimin e HRDD-së për të identifikuar dhe trajtuar sfidat e të drejtave të njeriut. Prania e tyre në Ballkanin Perëndimor jep mundësi për një integrim dhe zbatim më të gjerë të të drejtave të njeriut dhe standardeve mjedisore në të gjithë rajonin dhe një ndryshim të prioriteteve afatgjata drejt theksimit të rëndësisë dhe qëndrueshmërisë së investimeve.

Në përgjithësi, edhe pse qeveritë e rajonit nuk e kanë adresuar ende plotësisht ndikimin e operacioneve të biznesit në të drejtat e njeriut dhe mjedis, iniciativat e fundit ilustrojnë fokusin e tyre më të madh në këtë fushë. Aktualisht në rajon janë duke u zhvilluar shumë procese të reformave që synojnë përshtatjen e kornizave ligjore me standardet e BE-së në këtë fushë. Për shembull, rajoni ka filluar të angazhohet në këtë çështje përmes futjes në zbatim të raportimit jo-financiar të korporatave^[83] dhe duke marrë parasysh kriteret sociale dhe mjedisore gjatë kryerjes së aktiviteteve të prokurimit publik.^[84] Megjithatë, duhet të bëhet shumë më tepër për

-
- 78 Kompania Coca Cola, 'Politikat e të Drejtave të Njeriut' në dispozicion në <https://www.coca-colacompany.com/policies-and-practices/human-rights-principles>
- 79 Jon Springer, "Ahold Delhaize identifikon prioritetet e të drejtave të njeriut" (Winsight Grocery Business, 16 qershor 2020) në dispozicion në <https://www.winsightgrocerybusiness.com/retailers/ahold-delhaize-identifies-human-rights-priorities>.
- 80 Ball, 'Të drejtat e njeriut' në dispozicion në <https://www.ball.com/human-rights>.
- 81 Henkel, 'Të drejtat e njeriut dhe standardet sociale', në dispozicion në <https://www.henkel.com/sustainability/positions/human-rights>.
- 82 Michelin, 'Respektimi i të Drejtave të Njeriut', në dispozicion në <https://www.michelin.com/en/sustainable-development-mobility/for-people/respecting-human-rights/>.
- 83 Për shembull në Serbi, raportimi jofinanciar i korporatave është futur në zbatim përmes Ligjit për Kontabilitet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë nr. 73/2019 dhe 44/2021). Në Mal të Zi projektndryshimet në Ligjin për Kontabilitet (që aktualisht është në procedurë) përfshijnë edhe ato për raportimin jofinanciar.
- 84 Programi i sapo miratuar i Serbisë për Zhvillimin e Prokurimit Publik (2019-2023) e përcakton promovimin dhe inkurajimin e aspektit mjedisor dhe social në prokurimin

të arritur tek një mjedis biznesi dhe investimi në të cilin parimi ‘mos bëj dëm’ do të jetë standard themelor. Kjo pjesërisht do të përfshijë fokusimin në sferat e rregullimit ligjor që tradicionalisht janë perceptuar si neutrale në çështjet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, siç janë prokurimi publik, investimet, ligji tatimor dhe ligji për korporatat/kompanitë.^[85]

Siç është pranuar nga një raport i kohëve të fundit mbi përfitimet e mundshme për BE-në nga vendosja e zinxhirëve të furnizimit në Ballkanin Perëndimor, rajoni në fund të fundit e dëshiron anëtarësimin në BE. Megjithatë, qasja e BE-së e bazuar në vlera ndaj politikës së jashtme kërkon që ajo të përmbushë objektivat e saj për të drejtat e njeriut dhe mjedisin, si dhe objektivat e saj për zgjerimin dhe pavarësinë ekonomike të BE-së. Kjo është bërë veçanërisht e qartë në njoftimin e fundit të BE-së për shtytjen e saj drejt infrastrukturës ‘Global Gateway’, ‘bashkëpunimi i bazuar në vlera’ i të cilës po paraqitet si kundërvënie tërheqëse ndaj nismës kineze ‘Belt and Road’ (Një brez, një rrugë).^[86]

Investimi (i kushtëzuar) i BE-së në Ballkanin Perëndimor, pra, është ‘investim në të ardhmen e përbashkët dhe të orientuar kah vlerat e Evropës si tërësi’.^[87] Bizneset kanë një rol të rëndësishëm për të ndihmuar rajonin për tu takuar me BE-në në gjysmë të rrugës.

publik si një prej qëllimeve strategjike, dhe Ligji i Prokurimit Publik i vitit 2019 përmban dispozita që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, përfshirë edhe mundësinë e përdorimit të aspekteve mjedisore dhe sociale në të gjitha fazat e procedurës së prokurimit publik.

85 B Sjañfjell, ‘Si ligji i shoqërive tregtare ka dështuar në të drejtat e njeriut – dhe çfarë duhet bërë për këtë’ 2020 5 (2) Revista Biznesi dhe të Drejtat e Njeriut 179-199.

86 Jorge Vallero, John Follain, Shtytja infrastrukturore “Global Gateway” të BE-së si kundërvënie ndaj nismës “Belt and Road” të Kinës (Bloomberg, 30 nëntor 2021), në dispozicion në <https://www.bloomberg.com/news/articles/2021-11-30/eu-eyes-300-billion-euro-infrastructure-push-to-challenge-china>.

87 Zoran Nechev, Marie Jelenka Kirchner, ‘Koha për të lëvizur në Ballkanin Perëndimor: Si mund të ndihmojë diversifikimi i zinxhirëve global të furnizimit në qëndrueshmërinë e BE-së’ Dokument i politikave Nr.9/2021 (Prill 2021).

5. Përfundime

Harmonizimi i obligimeve në rritje të firmave për të garantuar të drejtat e njeriut me trysnitë tregtare ka gjasa të jetë burim tensioni, veçanërisht në një rajon ku agjenda e BHRE-së duhet të pranojë praktikatat ekzistuese dhe prioritetet lokale. Shpesh sugjerohet se vendet në zhvillim duhet t'i japin përparësi rritjes së shpejtë ekonomike ndaj standardeve të BHRE-së, të cilat zakonisht zënë vend qendror vetëm pasi një vend të ketë arritur një nivel të caktuar të zhvillimit socio-ekonomik. Gjithashtu, ndonëse është e vërtetë që një numër në rritje i korporatave shumëkombëshe po bëhen pjesë e agjendës së BHRE-së, shumë prej tyre nuk janë të përkushtuara përnjëmend për të promovuar këto standarde në praktikatat e tyre të biznesit dhe i përdorin kornizat jo aq të rrepta rregullative në vendet nikoqire. Një studim nga Joint Ethical Trading Initiative me mbi 1500 furnitorë e konfirmojë këtë: blerësit shpesh bien ndesh me kërkesat e veta të HRDD-së në praktikatat e tyre të blerjes, siç janë koha e prodhimit, çmimet dhe specifikimet teknike, duke u kërkuar furnitorëve që shpesh të pranojnë porosi nën kostot e prodhimit, gjë që pastaj ua bën atyre të pamundur të paguajnë paga me të cilat mund të jetohej, apo edhe pagat minimale.^[88]

Është e qartë se kërkohen përpjekje të mëdha për të siguruar që firmat të mund të mbajnë hapin me trysnitë komerciale dhe në të njëjtën kohë të mbrojnë të drejtat e njeriut, të ruajnë objektivat zhvillimore ekzistuese dhe të përmirësojnë reputacionin e tyre dhe përfitimin afatgjatë. Megjithatë, lidhja ndërmjet nevojës për të ruajtur dhe promovuar të drejtat e njeriut dhe mjedisin, nga njëra anë, dhe rrethanave aktuale tregtare globale, nga ana tjetër, po bëhet më e qartë; ajo është kërkesë e konsumatorëve dhe investitorëve por edhe mënyrë për të eliminuar rrezikun në zinxhirët e furnizimit dhe investime në një kohë të një pasigurie të madhe nga rreziqet gjeopolitike, ndryshimet klimatike dhe Covid-19.^[89]

88 Lise Smit et al., Studim mbi kërkesat për të treguar zellin e duhur në tërë zinxhirin e furnizimit: Raporti përfundimtar' (Komisioni Evropian, 2020) 964.

89 Ekzistojnë edhe rreziqe në lidhje me fuqinë punëtore që lindin nga prania e Kinës në Ballkanin Perëndimor, që prekin punëtorët dhe komunitetet lokale, si dhe punëtorët

Është e vështirë të vlerësohet ndikimi i pandemisë që është duke vazhduar Covid-19 në agjendën e BHRE-së. Pandemia ka nxjerr në sipërfaqe pabarazi të mëdha brenda dhe ndërmjet shteteve, duke përfshirë edhe BE-në. Ajo ka demonstruar se sa bizneset e suksesshme mbështeten në fuqinë punëtore të shëndetshme dhe në zinxhirë të përbashkët të furnizimit, dhe anasjelltas sa janë të cenueshme ato mjedise biznesi ku nuk mbështeten punëtorët. Duke nxjerrë në shesh këto pabarazi dhe çështje sistematike, pandemia vetëm sa ka përforcuar argumentet për adoptimin e praktikave të qëndrueshme të biznesit, duke përshpejtuar ndryshimin drejt, dhe duke rritur vlerën e zotërimit të aseteve ESG në proces.

Ky punim është përpjekur të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme të lëvizjes që po rritet me shpejtësi që e sheh mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe mjedisin si të pajtueshme me suksesin tregtar. Dëshmi të shumta nga praktika e biznesit tregojnë se qasja tregtare e udhëhequr në mënyrë të qëndrueshme është sigurisht e mundur dhe paraqet të ardhmen e tregtisë globale. Është e qartë se treni drejt mbrojtjes së detyrueshme dhe më të gjerë është nisur nga stacioni. Se a do të përfitojnë apo humbasin bizneset nga ky fakt, do të përcaktohet nga momenti që ata zgjedhin të hipin në këtë tren. Ata që i zbatojnë praktikatat e mira herët dhe në mënyrë vullnetare do të kenë një tranzicion më pak të kushtueshëm dhe do të gëzojnë përparësi dhe mundësi të shumta konkurruese. Firmat dhe shtetet që vazhdojnë ta injorojnë këtë trend e bëjnë këtë në dëm të tyre.

emigrantë kinezë në rajon. Një tipar i pranishëm në Kinës në rajon ka qenë përdorimi i marrëveshjeve dypalëshe si 'Ligji i Serbisë për Konfirmimin e Marrëveshjes për Sigurimet Sociale me Kinën', sipas të cilit ligji kinez i punës zbatohet për punëtorët emigrantë kinezë në Serbi në pesë vitet e para të qëndrimit të tyre. Edhe pse marrëveshjet dypalëshe të këtij lloji janë të zakonshme, kjo është e vetmja me një kufizim të tillë. Sasa Dragojlo "Si të burgosur": Punëtorët kinezë në Serbi ankohen se po shfrytëzohen' (Balkans Insight, 26 janar 2021) në dispozicion në <https://balkaninsight.com/2021/01/26/like-prisoners-chinese-workers-in-serbia-complain-of-exploitation/>.

Lista e shkurtesave

Shkurtesa	Anglisht	Shqip
BHRE	Business and human rights, including environmental protection	Biznesi dhe të drejtat e njeriut, përfshirë mbrojtjen mjedisore
CEDAW	Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave
CESCR	Committee on Economic, Social and Cultural Rights	Komisioni për të Drejtat Ekonomike dhe Kulturore
CSR	corporate social responsibility	përgjegjësia sociale e kompanisë
ECHR	European Convention on Human Rights	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ)
ECtHR	European Court of Human Rights	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ)
ESG	Environmental Social Governance	Qeverisje Sociale Mjedisore
EU	European Union	Bashkimi Evropian
HRDD	Human rights due diligence	Zelli i duhur për të drejtat e njeriut
IACHR	Inter-American Commission on Human Rights	Komisioni Ndër-Amerikan për të Drejtat e Njeriut
ICCPR	International Covenant on Civil and Political Rights	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
ICESCR	International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
ILO	International Labour Organisation	Organizata Ndërkombëtare e Punës
MNE	Multinational enterprise	Ndërmarrje shumëkombëshe

Shkurtesa	Anglisht	Shqip
NCP	National Contact Point	Person Kontaktues në Nivel Vendi
NFRD	Non-Financial Reporting Directive	Direktivë Raportuese Jofinanciare
OECD	Organisation for Economic Cooperation and Development	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PRI	Principles for Responsible Investment	Parimet e Investimit të Përgjegjshëm
SFDR	Sustainable Finance Disclosure Regulation	Rregullorja për Zbulimin e Financave të Qëndrueshme
TCRFD	Taskforce on Climate Related Financial Disclosures	Task Forca për Zbulimet Financiare lidhur me Klimën
UK	United Kingdom	Mbretëria e Bashkuar
UN	United Nations	Kombet e Bashkuara
UNGPs	United Nations Guiding Principles on Business and Human Rights	Parimet Udhëheqëse të Kombeve të Bashkuara për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut

Sustineri Partners

Sustineri Partners është themeluar nga një grup ekspertësh që besojnë në fuqinë e kompanive për të sjellë rezultate pozitive për shoqërinë. Kompania ofron këshilla strategjike për organizatat private dhe publike se si të përfshijnë standardet e qëndrueshmërisë në vendimet, praktikat dhe partneritetet e tyre. Puna e Sustineri Partners në mbështetjen e kompanive, investitorëve dhe organizatave të tjera përfshinë çështjet mjedisore, sociale (të drejtat e njeriut) dhe qeverisëse, me ekspertizë të veçantë në çështjet si skllavëria moderne, barazia gjinore, standardet mjedisore, luftimi i korrupsionit dhe qeverisja e mirë.

Qendra AIRE

Qendra AIRE është organizatë jo-qeveritare specialiste që ofron ekspertizë dhe këshilla praktike në lidhje me standardet ligjore të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, dhe ka përvojë të veçantë në proceset gjyqësore para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ku ka marrë pjesë në mbi 150 çështje. Për njëzet vite me radhë, Qendra AIRE ka krijuar një reputacion të pashoq në Ballkanin Perëndimor duke vepruar në të gjitha nivelet e sistemeve të drejtësisë në rajon. Ajo ka bashkëpunim të ngushtë me ministrinë e drejtësisë, qendrat e aftësimin ligjor, dhe me gjykatat kushtetuese dhe supreme duke mbështetur dhe ndihmuar shtetin e së drejtës dhe projektet e reformave. Gjithashtu, Qendra AIRE bashkëpunon me sektorin e OJQ-ve në tërë rajonin për të ndihmuar fuqizimin e reformave ligjore dhe respektimin e të drejtave themelore.

